



**PËR NJË LEGJISLACION EFEKTIV,
SI PËR GRATË, ASHTU DHE PËR BURRAT:
UDHËZUES PRAKTIK
PËR LEGJISLACIONIN
ME NDJESHMËRI GJINORE**



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



**PËR NJË LEGJISLACION EFEKTIV,
SI PËR GRATË, ASHTU DHE PËR BURRAT:
UDHËZUES PRAKTIK
PËR LEGJISLACIONIN
ME NDJESHMËRI GJINORE**

Ky dokument u botua fillimisht nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODHIR) në vitin 2017 me titullin origjinal "Making Laws Work for Women and Men: A Practical Guide to Gender-Sensitive Legislation". Ky variant i studimit në gjuhën shqipe u përgatit dhe u botua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret lirisht dhe të kopjohet për qëllime edukimi dhe jokomerciale, me kusht që çdo përdorim të shoqërohet me shënimin se burimi i materialit është Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Pasqyra e lëndës

HYRJE 5

PJESA I. BARAZIA GJINORE DHE INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS SË BARAZISË GJINORE:
KUADRI NDËRKOMBËTAR 9

PJESA II. LEGJISLACIONI ME NDJESHMËRI GJINORE (LNGj):
PËRKUFIZIMET, PARIMET DHE PËRPARËSITË 13

- (a) Konceptet dhe parimet e LNGj-së 13
- (b) Avantazhet e LNGj-së 16
- (c) Çfarë ndodh në mungesë të LNGj? 18
- (d) Roli i organeve ligjvënëse në LNGj 18

PJESA III. REALIZIMI I ANALIZËS LNGj 21

Hapi 1: Të kuptuarit e çështjeve gjinore në një fushë të caktuar: analiza e nevojave dhe mbledhja e të dhënave 21

i. Përcaktimi i analizës së nevojave 22

ii. Mbledhja e të dhënave 23

iii. Angazhimi me palët e interesuara 26

iv. Bashkimi i pjesëve 27

Hapi 2: Vlerësimi i ndikimit gjinor të një ligji specifik 29

Hapi 3: Integrimi i aktiviteteve me fokus gjinor në një projekt lig 31

Hapi 4: Krijimi i treguesve për matjen e ndikimit të mundshëm gjinor	32
Implikimet financiare të LNGj-së: Analiza e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor	33

PJESA IV. METODAT PËR INSTITUCIONALIZIMIN E LNGJ-SË	37
(a) Miratimi i një strategjie veprimi LNGj	38
(b) Ngritja e infrastrukturës për LNGj	40
i. Komisione të posaçme për barazinë gjinore	41
ii. Komisionet shumëportofolëshe që përfshijnë barazinë gjinore	43
iii. Strukturat parlamentare të grave dhe rrjetet joformale	45
iv. Njësitë teknike gjinore dhe shërbime kërkimore të jashtme	46
(c) Faktorët favorizues për prezantimin e LNGj-së	47

PJESA V. PËRFUNDIME	49
---------------------	----

SHTOJCA I. LNGJ NË BJELLORUSI: RAST STUDIMOR	51
(a) Panorama e barazisë gjinore në Bjellorusi	51
(b) Analiza LNGj në Bjellorusi: palët e interesuara dhe pikënisjet	54
(c) Mundësitë për veprim të mëtejshëm	57

SHTOJCA II. INSTRUMENTI I VETËVLERËSIMIT PËR LEGJISLACIONIN ME NDJESHMËRI GJINORE	61
(a) Informacion i përgjithshëm	61
(b) Hartimi	62
(c) Zbatimi	63
(d) Monitorimi	64
(e) Vlerësimi dhe shqyrtimi	64
(f) Administrata	65

SHTOJCA III. SHEMBUJ TË TREGUESVE ME NDJESHMËRI GJINORE NË SEKTORIN E ARSIMIT	67
---	----

FJALOR	71
--------	----

BIBLIOGRAFI	75
-------------	----

Hyrje

Arritja e barazisë midis grave dhe burrave është shndërruar në një objektiv madhor, si dhe në një pjesë të pandashme të agjendës zhvillimore ndërkombëtare. Parimi i barazisë gjinore mishëron idenë se të drejtat e njeriut nuk mund të arrihen pa garantuar që gratë dhe burrat të gëzojnë të drejta, përgjegjësi dhe mundësi të plotë dhe të barabarta. Ky parim përmbahet në shumë traktate ndërkombëtare, kushtetuta dhe legjislacione kombëtare në mbarë botën, përfshirë rajonin e OSBE-së dhe angazhimet e vetë OSBE-së.

Duke qenë se barazia gjinore shihet si një synim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë i politikave, integrimi i perspektivës së barazisë gjinore (gender mainstreaming) përbëhet nga një tërësi përfaqësues strategjike sipas konteksteve specifike dhe proceseve teknike dhe institucionale, që miratohen për të arritur këtë qëllim. Integrimi i perspektivës gjinore përfshin elementët e barazisë gjinore në funksionimin e organizatave kombëtare publike dhe private, në politikat qendrore ose vendore, si dhe në shërbimet dhe programet sektoriale. Në planin afatgjatë, ai synon të ndryshojë praktikën dhe institucionet sociale diskriminuese, duke njohur faktin se diskriminimi mund të përmbahet haptazi ose fshehurazi në një sërë ligjesh, normash kulturore dhe praktikash në komunitet.

Integrimi i perspektivës gjinore ka rëndësi thelbësore për sigurimin e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale për gratë, ashtu edhe për burrat. Gjithashtu, po pranohet gjithnjë e më shumë ideja se integrimi i perspektivës gjinore në fusha të ndryshme të zhvillimit ndihmon në arritjen e qëllimeve të tjera sociale dhe ekonomike. Integrimi i perspektivës gjinore mund të zbulojë nevojën për ndryshime në objektiva, strategji dhe masa, për të bërë të mundur që gratë ashtu si edhe burrat të ndikojnë, të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga proceset e zhvillimit. Kjo mund të sjellë ndryshime në organizata - struktura, procedura dhe kultura - për të krijuar mjedise organizative të favorshme për promovimin e barazisë gjinore.

Parlamentet kombëtare janë në pozitë solide për të arritur objektivin e barazisë gjinore dhe për të promovuar integrimin e perspektivës gjinore në qeveri. Parlamentet synojnë të jenë pasqyrë e shoqërisë, kështu që duhet të pasqyrojnë ndryshimin e dinamikave në elektoratet e tyre. Një parlament me ndjeshmëri gjinore është i aftë t'u përgjigjet nevojave dhe interesave, si të burrave, ashtu edhe grave në përbërjen, strukturat, operacionet, metodat dhe punën e tij. Për shembull, parlamentet me ndjeshmëri gjinore mund të kontribuojnë në heqjen e pengesave për pjesëmarrjen e plotë të grave në shoqëri dhe në fuqizimin e burrave dhe grave për të formësuar jetën e tyre dhe për të marrë vendime.

Procesi ligjvënës është një pikënisje jetike për integrimin gjinor. Legjislacioni ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të prekshëm në jetën e qytetarëve dhe pasqyron nevojat dhe prioritetet e zonave të ndryshme në mënyrën më të drejtpërdrejtë. Procesi ligjvënës krijon një platformë për dialog për çështjet me rëndësi parësore në shoqëri dhe mund të nxitë shprehjen e zërave dhe perspektivave të shumta. Pra, ky proces është një mjet efektiv për promovimin e vlerave dhe parimeve të barazisë gjinore.

Ky udhëzues u drejtohet kryesisht deputetëve dhe stafit parlamentar. Ai synon të japë orientime praktike në lidhje me legjislacionin me ndjeshmëri gjinore (LNGj), rëndësinë e tij, komponentët e tij, dhe mënyrat e përfshirjes dhe përdorimit të tij në punën e përditshme parlamentare.

- **Pjesa I** jep panoramën e përgjithshëm të kuadrit ndërkombëtar për barazinë gjinore dhe integrimin gjinor.
- **Pjesa II** shtjellon konceptet e LNGj-së, parimet dhe përfitimet; trajton çështjet se çfarë është LNGj-ja dhe çfarë nuk është, si edhe ndalet në rolin e parlamenteve në promovimin e LNGj-së.
- **Pjesa III** tregon hap pas hapi si zbatohet LNGj-ja dhe jep rekomandime në lidhje me mënyrën në të cilën realizohet analiza e nevojave gjinore në një sektor të caktuar, si vlerësohen implikimet gjinore të ligjeve specifike, nëse aktivitetet me fokus gjinor duhet të integrohen në akte të reja ligjore dhe në çfarë mënyre, si dhe krijimin e treguesve të ndjeshmërisë gjinore për të lehtësuar monitorimin e zbatimit të ligjit. Kjo pjesë ndalet edhe te parimet kryesore të analizës së buxhetit gjinor, që është komponent thelbësor i çdo LNGj-je të suksesshme.
- **Pjesa IV** përcakton qasjet për institucionalizimin e LNGj-së në punën rutinë të parlamenteve, duke u mbështetur në shembujt e praktikave më të mira

parlamentare nga mbarë bota, përfshirë shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Kjo pjesë përqendrohet në tre parime kryesore për integrimin e LNGj-së në parlamente: miratimin e një strategjie veprimi për LNGj-në, krijimin e infrastrukturës parlamentare për LNGj-në dhe bashkëpunimin me aktorët e jashtëm. Në këtë pjesë përfshihen gjithashtu edhe faktorët nxitës që kontribuojnë në institucionalizimin e LNGj-së.

- **Pjesa V** paraqet përfundime dhe praktika të mira në lidhje me zbatimin e LNGj-së.
- **Shtojca I** paraqet analizën e integritit gjinor në Republikën e Bjellorusisë¹, si rast studimor. Kjo Shtojcë përshkruan barazinë gjinore dhe praktikatat LNGj ekzistuese në këtë vend dhe evidenton pikënisjet për futjen e analizës sistematike të LNGj-së.
- **Shtojca II** përshkruan një instrument vetëvlerësimi për LNGj-në, duke orientuar lexuesit dhe profesionistët përmes fazave të ndryshme të ligj-bërjes nga perspektiva gjinore.
- **Shtojca III** jep shembuj treguesish të ndjeshmërisë gjinore për sektorin e arsimit.

1 Ky publikim është mbështetur nga projekti ekstra buxhetor i ODIHR "Forcimi i qeverisjes demokratike dhe barazisë gjinore në vendet e Partneritetit Lindor". Republika e Bjellorusisë u përzgjedh si rast studimor për këtë Udhëzues.

Pjesa I. Barazia Gjinore dhe Integrimi i Perspektivës së Barazisë Gjinore: Kuadri Ndërkombëtar

“Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë “ është një ndër parimet themelore të Kartës së Kombeve të Bashkuara të miratuar nga udhëheqësit botërorë më 1945. Parimi i barazisë gjinore u njoh edhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut në vitin 1948, e cila afirmoi “të drejtat e barabarta të burrave dhe grave”. Deklarata i hapi rrugën forcimit të mëtejshëm të angazhimeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të grave, sidomos me Konventën e Kombeve të Bashkuara (OKB) për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) të vitit 1979. Konventa përmban një “kartë të të drejtave” për gratë, duke përcaktuar se çfarë përbën diskriminim ndaj grave dhe ofron një agjendë kombëtare për t’i dhënë fund këtij diskriminimi. Deri në vitin 2016, 187 shtete e kanë ratifikuar CEDAW-n, përfshirë 56 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së; shumë prej tyre prezantuan parimet e barazisë gjinore në legjislacionin për shëndetësinë, arsimin, punësimin, familjen dhe martesën, parandalimin e trafikimit të grave dhe fëmijëve, si edhe në kodet penale.

Në vitin 1995, në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare për Gratë mbajtur në Pekin, integrimi i perspektivës së barazisë gjinore u trajtua specifikisht në Platformën për Veprim të Pekinit si një strategji e miratuar ndërkombëtarisht për promovimin e barazisë gjinore². Platforma angazhon të gjitha palët e interesuara në politika dhe programe zhvillimi - përfshirë subjektet e Kombeve të Bashkuara, shtetet anëtare, agjensitë ndërkombëtare të zhvillimit dhe aktorët e shoqërisë civile – që të ndërmarrin veprime «për të siguruar akses të barabartë të grave dhe pjesëmarrje

2 Ideja e integritit të shqetësimeve të grave arriti të përfshihej fillimisht në punën e Kombeve të Bashkuara në “Strategjinë që shohin përpara për avancimin e grave”, miratuar në Konferencën e Tretë Botërore për Gratë, në Nairobi, 1985, http://www.5wwc.org/conference_background/1985_WCW.html.

të plotë të tyre në vendimmarrjen dhe strukturat e pushtetit». Po atë vit, Asambleja e Përgjithshme miratoi një rezolutë që përcaktonte integrimin gjinor si një politikë në mbarë Kombet e Bashkuara.³

Në Kombet e Bashkuara, përkufizimi i integritit të perspektivës së barazisë gjinore u përcaktua në vitin 1997, nga Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB-së (ECOSOC):

“Integrimi i perspektivës gjinore është procesi i vlerësimit të implikimeve për gratë dhe burrat për çdo veprim të planifikuar, përfshirë legjislacionin, politikat apo programet, në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Integrimi është një strategji për t’i bërë shqetësimet dhe përvojat e grave dhe burrave dimension të pandashëm të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë njësoj dhe pabarazia të mos tolerohet. Qëllimi përfundimtar është arritja e barazisë gjinore.”⁴

Si e tillë, barazia gjinore është qëllim zhvillimor gjithëpërfshirës afatgjatë, ndërsa integrimi i perspektivës së barazisë gjinore është një metodë që konsiston në qasje strategjike sipas kontekstit, si edhe në proceset teknike dhe institucionale të miratuara për arritjen e këtij qëllimi.

Integrimi i perspektivës gjinore përfshin komponentët e barazisë gjinore në organizatat kombëtare publike dhe private, në politikat qendrore ose vendore, si dhe në shërbimet dhe programet sektoriale. Në planin afatgjatë, ai synon të ndryshojë praktikën dhe institucionet sociale diskriminuese, duke njohur faktin se diskriminimi mund të mishërohet në ligje, norma kulturore dhe praktika në komunitet, të cilat, për shembull, pengojnë aksesin e grave në të drejtat e pronës ose kufizojnë aksesin e tyre në hapësirën publike.

Në kuadër të Objektivit 3 të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (Fuqizimi i Grave), OKB-ja inkurajon Shtetet Anëtare të zhvillojnë një kuadër ligjor ku perspektiva gjinore integrohet në nivel qeveritar dhe parlamentar. Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm ripohoi angazhimin për barazi gjinore dhe integrimin e perspektivës gjinore, duke miratuar një numër objektivash, përfshirë Objektivin nr. 5 për “realizimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha gratë dhe vajzat”, ku theksohet se:

3 Ndjekje e Konferencën së Katërt Botërore për Gratë dhe Zbatimit të Plotë të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 50/203, 1995, <<http://www.un.org/documents/ecosoc/res/1996/eres1996-6.htm>>.

4 Integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha politikën dhe programet në sistemin e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta ECOSOC, Pasazh nga A/52/3, Kreu IV, 1997, <<http://www.un.org/womenwatch/osagi/pdf/ECOSOCAC1997.2.PDF>>.

“Realizimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave do të japë një kontribut vendimtar në përparimin në të gjithë Objektivat dhe synimet. [...] Gratë dhe vajzat duhet të gëzojnë akses të barabartë në arsim cilësor, burime ekonomike dhe pjesëmarrje politike, si dhe mundësi të barabarta me burrat dhe djemtë në punësim, udhëheqje dhe vendimmarrje në të gjitha nivelet. [...] Të gjitha format e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave do të eliminohen, përmes edhe angazhimit të burrave dhe djemve. Integrimi sistematik i një perspektive gjinore në zbatimin e Agjendës është thelbësor”⁵.

Bashkimi Evropian e njohu integrimin e perspektivës gjinore si një strategji udhëzuese drejt barazisë gjinore, dhe vendosi të promovojë barazinë gjinore në të gjitha fushat e politikbërjes. Në vitin 1999, Traktati i Amsterdami përfshiu në detyrat themelore të BE-së promovimin e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit midis burrave dhe grave. Gjatë viteve, janë miratuar një sërë direktivash lidhur me barazinë gjinore dhe, në vitin 2006, u përmblohdhën të gjitha në të ashtuquajturën Direktivë Gjinore e Konsoliduar.⁶ BE-ja ka pasur ndikim pozitiv në zhvillimin e politikës së barazisë gjinore, jo vetëm te Shtetet Anëtare, por edhe në vende të tjera evropiane, ku kandidatura për aderim apo marrëdhënie të tjera të lidhura me asistencën u kërkon vendeve të punojnë drejt pajtueshmërisë me normat e BE-së.

Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore (2004) lidh drejt-përsëdrejti të drejtat e barabarta të grave dhe burrave me “paqen, demokracinë e qëndrueshme, zhvillimin ekonomik dhe, për rrjedhojë, me sigurinë dhe stabilitetin në rajonin e OSBE-së”. Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i OSBE-së – i cili përbën kuadrin më të plotë të OSBE-së deri më sot, në udhëzimin e institucioneve të OSBE-së dhe të Shteteve Pjesëmarrëse për barazinë gjinore - thekson nevojën “për të zhvilluar më tej dhe për të forcuar procesin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të integritimit gjinor”. Plani i Veprimit e detyron OSBE-në që objektivin e integritimit të perspektivës gjinore ta përfshijë në të gjitha programet dhe veprimet e veta, si edhe të mbështetë arritjen e këtyre objektivave në asistencën që OSBE-ja jep për Shtetet Pjesëmarrëse.⁷

Pjesa më e madhe e shteteve anëtare të OSBE-së e kanë nënshkruar dhe e kanë ratifikuar CEDAW-n dhe kanë marrë përsipër angazhime ndërkombëtare për

5 Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, 2015, paragrafi 20, <<https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>>.

6 Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit, 5 korrik 2006, “<<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32006L0054>>.

7 Vendimi i Këshillit Ministror të SCE Nr. 14/04, “Plani i Veprimit i OSBE-së 2004 për Promovimin e Barazisë Gjinore”, Sofje, 7 dhjetor 2004, <<http://www.osce.org/mc/23295?download=true>>.

mbrojtjen dhe promovimin e barazisë gjinore. Edhe pse legjislacioni kombëtar përgjithësisht përmban dispozita të qarta që ndalojnë diskriminimin me bazë gjinore, natyra deklarative e këtyre dispozitave nuk përkthehet automatikisht në mekanizma për të siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e grave në të gjitha llojet e aktiviteteve shoqërore, politike dhe ekonomike, në nivel të barabartë me burrat. Për rrjedhojë, integrimi i perspektivës gjinore në legjislacion luan rol të rëndësishëm në procesin e promovimit dhe arritjes së objektivit madhor të barazisë gjinore.

Pjesa II. Legjislacioni me Ndjeshmëri Gjinore (LNGj): Përkufizimet, Parimet dhe Përparësitë

Ky seksion shpjegon nocionet bazë të legjislacionit me ndjeshmëri gjinore (LNGj) dhe nënvizon përparësitë kryesore të tij në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore në legjislacion dhe në buxhete.

(a) Konceptet dhe parimet e LNGj-së

Legjislacioni me ndjeshmëri gjinore është një element thelbësor për integrimin e perspektivës së barazisë gjinore në sistemin juridik. Ai integron perspektivën gjinore në të gjithë komponentët e procesit ligjvënës: hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e impaktit të legjislacionit, **në funksion të objektivit madhor të barazisë midis grave dhe burrave**. Ashtu si edhe përpjekjet e tjera për të integruar perspektivën gjinore, LNGj-ja është mjet për arritjen e barazisë, dhe jo qëllim në vetvete.

Për qëllimet e zbatimit të LNGj-së, **barazi gjinore** do të thotë të drejta dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në ligje dhe politika, si dhe akses të barabartë në burime dhe shërbime brenda familjeve, komuniteteve dhe në shoqëri. Ajo synon që gratë dhe burrat të jenë në gjendje të marrin pjesë në të gjitha sferat e jetës në nivel të barabartë, si p.sh. në qeverisjen demokratike, në vendimmarrje, në ligjëbërje dhe në sektorin e sigurisë. Barazia gjinore kërkon që gratë dhe burrat të kenë mbrojtje adekuata dhe të barabartë të të drejtave të tyre njerëzore, përfshirë të drejtën për të jetuar pa dhunë në një shtëpi dhe komunitet të sigurt dhe mbështetës.⁸

8 Barazia Gjinore dhe Të drejtat e Njeriut, Tabelë Informuese (Varshavë: ODIHR, 2017), <<http://www.osce.org/odihr/303541?download=true>>.

Barazia gjinore ka implikime të shumëfishta në kontekstin e LNGj-së, përfshirë këtu të drejtat e barabarta në shpërndarjen e burimeve dhe përfitimeve, si dhe në aksesin në shërbime dhe burime të tjera; shqyrtimin e barabartë të interesave, nevojave dhe prioriteteve të grave dhe burrave në formulimin e ligjeve dhe politikave; si dhe sigurimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, duke marrë parasysh nevojat dhe prioritetet e tyre të veçanta.

Realizimi i procesit të LNGj-së përfshin disa hapa:

- 1** Së pari, LNGJ kërkon **analizë të plotë të situatës nga perspektiva gjinore dhe mundësisht të nevojave dhe prioriteteve të veçanta të grave dhe burrave** në lidhje me ligjin nën shqyrtim. Kjo analizë, shpesh e quajtur “analizë gjinore”, synon të identifikojë sistematikisht problematikat kryesore që shkaktojnë pabarazinë gjinore, në mënyrë që ato të adresohen siç duhet nga legjislacioni. LNGJ mund të përshkruhet si një analizë e dallimeve në kushte, nevoja, norma pjesëmarrjeje, akses në burime dhe zhvillim, kontroll asetesh dhe kompetenca vendimmarrëse midis grave dhe burrave. Kjo analizë bazohet tek të dhënat ekzistuese mbi dallimet gjinore në një sektor të caktuar dhe mund të kërkojë mbledhjen e të dhënave të reja;
- 2** Së dyti, LNGJ përmban një **analizë të ndikimit të mundshëm të ligjit** mbi grupet e synuara, si dhe shqyrton nëse ligji adreson nevojat dhe prioritetet e grave dhe burrave, të cilat janë identifikuar nga analiza fillestare;
- 3** Së treti, bazuar në gjetjet e hapave të mëparshëm, procesi LNGj kërkon përfshirjen në ligjin në fjalë, sipas rastit, të **ndërhyrjeve, perspektivave apo konsideratave me fokus gjininë**; dhe
- 4** Së fundmi, procesi i LNGj përfshin hartimin e **treguesve të ndjeshmërisë gjinore** që mundësojnë monitorim dhe vlerësim sistematik të ecurisë së ligjit drejt objektivave gjinorë të përcaktuar në të.

Orientimet e hollësishme për zbatimin e secilit hap jepen në Pjesën III më poshtë.

Për të sqaruar kuptimin e LNGj-së, mund të duhet të kuptojmë se **çfarë NUK është LNGj-ja**:

- **LNGj-ja nuk nënkupton shtimin e termave “gjini” apo “barazi gjinore” në ligjet, politikat apo aktivitetet ekzistuese.** LNGj-ja është më shumë sesa thjesht përfshirje e terminologjisë “së duhur” në legjislacion, sepse kërkon përfshirje të përgjegjshme të perceptimeve, përvojave, njohurive

dhe interesave të grave dhe të burrave në procesin legjislativ, si pjesë e aktiviteteve specifike të parashikuara me ligj për gratë dhe burrat.

- **LNGj-ja nuk ka të bëjë vetëm me gratë.** LNGj-ja nuk lidhet ekskluzivisht vetëm me gratë, por me marrëdhënien midis grave dhe burrave për të mirën e ndërsjellë. Në shumë raste, LNGj-ja synon të nivelojë fushën e veprimit për gratë, në mënyrë që të përfitojnë nga mundësitë e barabarta. Megjithatë, kjo mund të përfshijë edhe veprime që iu adresohen grave dhe/ose burrave, ku ata diskriminohen për shkak të roleve gjinore të perceptuara.
- **LNGj-ja nuk është vetëm balancë gjinore apo paritet gjinor.** Balanca gjinore përdoret shpesh si term për burimet njerëzore, duke iu referuar numrit të grave të punësuar përkundrajt burrave të punësuar, por mund t'i referohet edhe raportit gra/burra si pjesëmarrës në çfarëdo aktiviteti (p.sh. numri i të diplomuarve gra dhe burra, apo gratë dhe burrat që përfitojnë shërbime në një klinikë shëndetësore). Arritja e balancës gjinore është një hap i mirë drejt arritjes së barazisë, por LNGj-ja nuk nënkupton thjesht shifra, por përmbajtje. Thjesht numërimi i grave dhe burrave dhe rritja e numrit të grave të pranishme në sallë nuk çon domosdoshmërisht në legjislatiion me ndjeshmëri gjinore. Ngulmimi i vazhdueshëm tek balanca gjinore mund të bazohet në mendimin e gabuar se të gjithë burrat janë të pandjeshëm ndaj çështjeve gjinore. Pjesëmarrja e barabartë e burrave dhe grave shihet si një hap drejt arritjes së barazisë.
- **LNGj-ja nuk do të thotë detyrimisht “neutralitet gjinor”.** Qasja e neutralitetit gjinor presupozon se gratë dhe burrat kanë të njëjtat nevoja dhe shqetësime. Por, përvoja tregon se gratë dhe burrat mund të kenë nevoja dhe prioritetë të ndryshme. Gratë dhe burrat mund të luajnë role të ndryshme në shoqëri, dhe të kenë përgjegjësi të ndryshme dhe nivele të ndryshme aksesi në burime dhe mallra. Në pjesën më të madhe të shoqërive, burrat dominojnë në vendimmarrjen e komunitetit dhe të familjes, dhe për këtë arsye, qasjet e neutralitetit gjinor në vend që të adresojnë nevojat e grave, mund t’iu përgjigjen më shumë prioritetëve të burrave.
- **LNGj-ja nuk kufizohet vetëm në promovimin e barazisë formale para ligjit.** Kur shqyrtohen jetët konkrete të burrave dhe grave, shpesh dalin në pah realitete të ndryshme. Shpesh gratë diskriminohen në tregun e punës, janë të nënpërfaqësuar në organet vendimmarrëse dhe ende mbajnë barrën më të madhe të punës së papaguar në shtëpi. Nga ana tjetër, në shumë raste jetëgjatësia e burrave është më e ulët sesa ajo e grave, pasi mund të ketë vëmendje të pamjaftueshme për nevojat e burrave në fushat e shëndetit

dhe sigurisë. Burrat kanë më pak gjasa sesa gratë të shkojnë për vizitë te mjeku kur janë të sëmurë; edhe kur shkojnë, kanë më pak gjasa të tregojnë simptomat e sëmundjes apo sëmundjen.

- **LNGj nuk nënkupton qasje shabllon për burrat dhe gratë që vlen për çdo kontekst.** Gratë dhe burrat nuk përbëjnë grupe homogjene. Përvojat e tyre mund të jenë të ndryshme bazuar në shumë veçori si përshebull: moshë, statusi civil, etnia, aftësia e kufizuar dhe shumë veçori të tjera. Prandaj, nuk përbën çudi që legjislacioni dhe politikat shtetërore të kenë ndikime të ndryshme te çdo nëngrup. Në këtë kontekst, LNGj-ja nuk është thjesht barazi mundësish, por edhe barazi rezultatesh. Kur njerëzve iu ofrohet një mundësi, shoqëria duhet të lehtësojë procesin e pjesëmarrjes duke hequr pengesat e mundshme. Kjo çon në arritjen e rezultateve më të barabarta për të gjithë individët.

(b) Avantazhet e LNGj-së

LNGj-ja është një qasje për të institucionalizuar promovimin e barazisë gjinore dhe arritjen e një sërë përfitimesh socio-ekonomike. Përvoja ndërkombëtare tregon se zvogëlimi i pabarazisë gjinore sjell nivele më të larta të rritjes ekonomike dhe ndihmon në arritjen e një sërë objektivash zhvillimi. Disa prej përfitimeve të LNGj-së janë:

- **Kontribuon në politika publike reaguese dhe të bazuar në prova** – Analiza gjithëpërfshirëse LNGj shqyrton shpërndarjen e burimeve midis përfituesve gra dhe burra, si edhe ndikimin e politikave publike dhe të shpenzimeve publike. Me këtë analizë, ligjvënësit marrin një bazë evidencash solide – që nuk mund të siguroheshin ndryshe, për të kuptuar më mirë nevojat dhe prioritetet e elektoratit, për të garantuar që legjislacioni i ri iu përgjigjet nevojave dhe kërkesave konkrete në terren, dhe rrjedhimisht të nivelojë pabarazitë gjinore. Natyrisht probabiliteti i zbatimit të plotë të një ligji apo një politike rritet ndjeshëm kur merren parasysh perspektivat dhe nevojat e të gjitha grupeve përfituese;
- **Forcimi i transparencës legjislative dhe llogaridhënies** – Duke zbuluar ndikimin gjinor të legjislacionit, analiza LNGj përmirëson transparencën dhe llogaridhënien e të gjithë procesit legjislativ. Ai u mundëson aktorëve joqeveritarë të monitorojnë punën e qeverisë në fusha të ndryshme dhe t’iu kërkojnë llogari qeveritarëve;
- **Përmirësimi i gjithëpërfshirjes dhe cilësisë së vendimmarrjes** - Fuqizimi i grave si aktorë ekonomikë, politikë dhe socialë mund të ndryshojë zgjedhjet

e politikave dhe t'i bëjë institucionet përfaqësues të më shumë zërave. Qasja LNGj siguron që pikëpamjet e grupeve të ndryshme të qytetarëve të paraqiten në të gjitha fazat e procesit legjislativ;

- **Monitorimi i arritjes së objektivave të politikave** - Analiza LNGj mundëson monitorimin se në çfarë mase janë realizuar standardet ndërkombëtare dhe kombëtare për përmirësimin e barazisë midis burrave dhe grave, si edhe të objektivave të tjera të politikave. Monitorimi ndihmon në identifikimin e boshllëqeve ndërmjet standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm që prek gratë dhe burrat në një sërë kontekstesh socio-ekonomike dhe politike;
- **Forcimi i rritjes ekonomike** - Sipas Raportit të Zhvillimit Botëror të përgatitur nga Banka Botërore për Barazinë Gjinore dhe Zhvillimin (2012), gratë tashmë përfaqësojnë 40% të fuqisë punëtore globale, 43% të fuqisë punëtore në sektorin e bujqësisë dhe mbi 50% të studentëve universitarë në botë⁹. Produktiviteti global do të rritet nëse aftësitë dhe talentet e grave do të përdoren në mënyrë më efektive. Për shembull, ligjet që eliminojnë barrierat që diskriminojnë gratë aktive në sektorë ose profesione të caktuara (p.sh. në bujqësi apo akses në kreditim) mund të rrisin produktivitetin ekonomik në disa vende deri në 25%. Kompanitë të cilat i kushtojnë vëmendje diversitetit gjinor kanë 15% më shumë probabilitet të jenë më fitimprurëse sesa kompanitë e ngjashme që nuk tregojnë këtë kujdes¹⁰.
- **Lufta ndaj diskriminimit** – Sipas Raportit mbi Progresin e Grave në Botë 2015-2016, përgatitur nga UN Women, gratë në mbarë botën fitojnë rreth 25% më pak sesa burrat për të njëjtën punë¹¹. Përveç kësaj, gratë bëjnë 75% të punës së papaguar në botë dhe prapëseprapë shpenzojnë mesatarisht 90% të pagës për familjet e tyre, duke krijuar një efekt domino pozitiv në të gjithë komunitetet e tyre. Një analizë e plotë LNGj mund të zbulojë këto dhe modele të tjera diskriminuese, si edhe të ndihmojë në zbutjen e tyre duke integruar masat e duhura në legjislacionin e ri; dhe
- **Forcimi i shtetit ligjor** – Ka gjithnjë e më shumë prova që tregojnë se të kuptuarit e marrëdhënieve, identiteteve dhe pabarazive gjinore gjatë procesit ligjvënës mund të ndihmojë në përmirësimin e shtetit të së drejtësi. Për

9 “Barazia Gjinore dhe Zhvillimi”, Raporti i Zhvillimit të Botës, Banka Botërore, 2012, <<https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/4391>>.

10 Po aty.

11 “Progresi i Grave në Botë 2015-2016”, UN Women, 20 tetor 2015, <<http://progress.unwomen.org/en/2015>>.

shembull, krimi ka ndikime thellësisht të ndryshme te gratë dhe burrat. Hulumtimet tregojnë se të rinjtë janë më të rrezikuar nga rekrutimi prej grupeve kriminale, ndërsa gratë janë më të rrezikuara nga dhuna në shtëpi nga dikush që është i njohur për ta. Gratë dhe burrat shpesh theksojnë shqetësime të ndryshme dhe sjellin perspektiva, përvoja dhe zgjidhje të ndryshme për çështjet. Të kuptuarit e këtyre dallimeve dhe pabarazive mund të ndihmojë në identifikimin e nevojave dhe në shënjestrimin e ndihmës, si edhe të garantojë që legjislacioni të përmbushë të gjitha nevojat dhe prioritetet e tyre sociale.

(c) Çfarë ndodh në mungesë të LNGj?

Të drejtat, përfitimet, shërbimet dhe mundësitë e parashikuara nga ligjet dhe politikat mund të ndikojnë te burrat dhe gratë në mënyra të ndryshme dhe të pabarabarta. Anashkalimi i nevojave dhe kapaciteteve të veçanta të grave dhe burrave redukton ndjeshëm efikasitetin dhe ndikimin e ligjeve dhe politikave, si dhe mund të përkeqësojë pabarazitë. Dallimet dhe pabarazitë e vazhdueshme midis grave dhe burrave mund të bëjnë që kostot e mungesës së zhvillimit të bien më shumë mbi gratë dhe ato të marrin më pak përfitime nga reforma legjislative se sa burrat.

Mungesa e integritit gjinor në procesin legjislativ sjell pasoja negative jo vetëm për gratë, por për shoqërinë në tërësi. Gratë përfaqësojnë gjysmën e burimeve dhe gjysmën e potencialit të çdo shoqërie. Burimet dhe potenciali i tyre mbeten të pashfrytëzuara nëse ato kufizohen nga pabarazia dhe diskriminimi. Zbutja e këtyre dy aspekteve bëhet edhe më e vështirë kur mungojnë prova të besueshme nëse legjislacioni kontribuon në këto pabarazi dhe në diskriminim, si edhe në çmwnyrw.

LNGj është jetik për të siguruar zhvillim ekonomik dhe social të qëndrueshëm dhe afatgjatë, pasi lejon identifikimin sistematik të mundësive për avancimin e barazisë gjinore në të gjitha ligjet dhe politikat e miratuara nga qeveria. Në aspektin operacional, integrimi i perspektivës së barazisë gjinore u mundëson politikë-bërësve dhe zbatuesve të politikave që jo vetëm të përqendrohen në pasojat e pabarazisë gjinore, por edhe të identifikojnë dhe adresojnë proceset që e shkaktojnë.

(d) Roli i organeve ligjvënëse në LNGj

Organet ligjvënëse mund të krijojnë hapësirë për dialog dhe ndërtimin e agjendave të përbashkëta ku përfshihen të gjithë zërat, prioritetet dhe interesat e shoqërisë. Këto organe janë në pozita të mira për të dhënë shembullin për agjencitë

shtetërore dhe organizatat e tjera në integrimin gjinor përmes procesit ligjvënës. Integrimi i perspektivës gjinore në organet ligjvënëse mundëson marrjen parasysh të shqetësimeve, nevojave dhe përvojave të grave dhe burrave në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit.

Miratimi i një qasjeje me ndjeshmëri gjinore iu mundëson ligjvënësve të arrijnë objektivat e mëposhtëm:

- Të sigurojë pranimin dhe garantimin e plotë të të drejtave të njeriut si të grave ashtu edhe të burrave, në legjislacionin ekzistues dhe të ri, përmes një analize gjinore gjithëpërfshirëse të ndikimit të një ligji të caktuar, si edhe shfrytëzimin e instrumenteve të reja ligjore për fuqizimin e burrave dhe grave;
- Të kontribuojë në zhvillimin e një buxheti me ndjeshmëri gjinore që merr në konsideratë nevojat dhe prioritetet e veçanta të grave dhe burrave dhe kërkon të eliminojë çdo diskriminim dhe pabarazi ekzistuese;
- Të monitorojë punën e agjencive shtetërore dhe zyrtarëve për të siguruar respektimin nga ana e tyre të angazhimeve ndërkombëtare dhe kombëtare për barazinë gjinore, si edhe të integrojnë aspektet gjinore në punën e tyre të përditshme;
- Të krijohen rrjete ndërpartiake bashkëpunimi, shkëmbimi të njohurive dhe ngritjes së kapaciteteve për ligjvënësit, që të promovojnë parimet e barazisë gjinore dhe zbutjen e pabarazive ekzistuese politike, sociale apo ekonomike midis burrave dhe grave.

Udhëzimet e hollësishme se si institucionalizohet LNGj-ja në organet ligjvënëse jepen në Pjesën IV më poshtë.

Pjesa III. Realizimi i Analizës LNGj

Kjo pjesë jep udhëzime për hapat që çojnë në përfshirjen e ndjeshmërisë gjinore në ligjet e reja apo legjislacionin ekzistues. Këto hapa përfshijnë: (i) analizën gjinore të situatës aktuale gjinore në një sektor të caktuar; (ii) analizën e ndikimit të mundshëm të një ligji të ri në nevojat dhe interesat nga perspektiva gjinore; (iii) integrimin, sipas rastit, të aktiviteteve të fokusuara në çështjet gjinore që iu përgjigjen nevojave të identifikuara me bazë gjinore; dhe (iv) përgatitjen e treguesve me ndjeshmëri gjinore për të monitoruar progresin.

Teksa rëndësia e arritjes së barazisë gjinore në arsim po merr gjithnjë e më shumë vëmendje, shumica e përpjekjeve të deritanishme janë fokusuar në vlerësimin e paritetit gjinor - numri ose përqindja e barabartë e vajzave dhe djemve me akses në mundësitë arsimore. Megjithëse pariteti gjinore është i rëndësishëm, integrimi i barazisë gjinore përfshin një koncept më të gjerë, ku pariteti gjinor përbën vetëm një pjesë. Arritja e barazisë gjinore nuk nënkupton vetëm akses të barabartë në arsim për vajzat dhe djemtë, por edhe nivel të njëjtë cilësie dhe rezultatesh nga arsimimi.

Hapi 1: Të kuptuarit e çështjeve gjinore në një fushë të caktuar: analiza e nevojave dhe mbledhja e të dhënave

Çdo legjislacion me ndjeshmëri gjinore kërkon një analizë gjithëpërfshirëse me bazë gjinore. Një analizë e tillë është parakusht për të bërë të mundur që çdo hap i hartimit, planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të ligjeve dhe politikave të marrë parasysh dallimet gjinore ekzistuese. Analiza jep mundësinë për identifikimin dhe adresimin e nevojave gjinore gjatë të gjithë ciklit të një nisme ligjore dhe iu mundëson përdoruesve të vlerësojnë se si ndërhyrjet do të ndikojnë në rolet, marrëdhëniet apo përgjegjësitë gjinore.

Në punësim, duke ua bërë më të lehtë grave të gjejnë vende pune në arsim ose shëndetësi, në mënyrë që të plotësojnë nevojën praktike për të ardhura; por, nëse nuk ka asnjë ndryshim në ndarjen e punës, barra e punëve të shtëpisë do të vazhdojë t'i pengojë gratë që të angazhohen në punë të paguar apo të ngjisin shkallët e karrierës.

Në arsim, një nevojë praktike mund të jetë akordimi i fondeve shtesë për sportet e vajzave, ndërsa një nevojë strategjike mund të jetë angazhimi i vajzave në sporte që zakonisht ushtrohen nga djemtë.

Në kujdesin e fëmijës, një nevojë praktike mund të jetë subvencionimi i qendrave ambulatorë (ditore) për familjet e varfra ose nënat beqare, ndërsa një nevojë strategjike mund të jetë reformimi i politikave të lejes së zakonshme për prindërit, në mënyrë që si nëna edhe babai të marrin ditë pushimi, që të kujdesen për fëmijët e tyre. Prandaj, gjatë hartimit të ligjeve dhe politikave, është e rëndësishme të mbahen parasysh nevojat praktike dhe të adresohen pabarazitë ekzistuese në kontekstin specifik, në kuadrin e një perspektive strategjike afatgjatë, që synon të sheshojë këto pabarazi duke trajtuar shkaqet rrënjësore.

Analiza gjithëpërfshirëse me bazë gjinore fillon me **një studim të nevojave praktike dhe strategjike të burrave dhe grave, nëpërmjet mbledhjes së të dhënave dhe angazhimit të palëve të interesuara.**

i. *Përcaktimi i analizës së nevojave*

Hapi i parë i analizës LNGj është vlerësimi i situatës aktuale dhe i nevojave të grave dhe burrave në sektorin specifik objekt i ligjit. Kjo analizë e nevojave synon të hedhë dritë mbi publikun e synuar të ligjit, të kuptojë dallimet e mundshme në nevojat dhe interesat e grave, vajzave, burrave dhe djemve, të identifikojë nevojat dhe prioritetet e tyre praktike dhe strategjike, si edhe të nxjerrë në pah nëse ekzistojnë pabarazi midis grave dhe burrave (ose nëngrupet e grave dhe burrave) që duhet të trajtohen nga ligji.

Analiza e nevojave zakonisht përqendrohet në dy faktorë:

- **Nevojat praktike** – Këto janë nevoja që lindin nga rrethanat e jetës së përditshme të grave dhe burrave, bazuar në rolet gjinore që iu janë caktuar nga shoqëria. Këto shpesh lidhen me detyrat prindërore dhe punët e shtëpisë, që iu janë caktuar më shumë grave sesa burrave.
- **Nevojat strategjike** – Këto nevoja përfshijnë eliminimin e varësisë së grave ndaj burrave në shoqëri dhe zgjerimin e mundësive për gratë. Ato varen nga kushte konkrete sociale, ekonomike dhe politike. Zakonisht, këto nevoja lidhen me çështjet e barazisë, si aksesimi i barabartë për gratë në mundësi punësimi dhe formim profesional, paga të barabarta për punë të njëjta, e drejta e pronësisë mbi tokën dhe pasurinë e paluajtshme, mbrojtja nga ngacmimi seksual dhe dhuna në familje, si edhe të drejtat dhe liritë riprodhuese. Adresimi i këtyre çështjeve çon në arritjen graduale të barazisë gjinore.

Vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet nevojave të veçanta të nëngrupeve të ndryshme. Gratë dhe burrat kanë nevoja të veçanta, që shpesh lidhen me shtresën shoqërore, përkatësinë etnike, moshën, statusin dhe përbërjen familjare, aftësinë e kufizuar dhe faktorë të tjerë. Për shembull, gratë urbane të shtresës së mesme nuk kanë domosdoshmëri të njëjtat pikëpamje dhe prioritetet si gratë e varfra rurale. Këto dallime duhet të merren plotësisht në konsideratë, me qëllim që të identifikohen me saktësi nevojat, interesat dhe prioritetet e secilit nëngrup.

Një analizë gjithëpërfshirëse e nevojave me bazë gjinore duhet të bazohet në të dhëna solide dhe tërësore, si edhe në konsultim me palët e interesuara që mund të japin informacion shtesë:

- **Mbledhja e të dhënave** – Çfarë të dhënash dhe materialesh reference mund të gjenden dhe të konsultohen?
- **Konsultimi me palët e interesuara** – Cilët zyrtarë shtetërorë, organizata të shoqërisë civile, shoqata profesionale dhe firma të sektorit privat mund të konsultohen për të kuptuar më mirë aspektet gjinore të situatës në sektor?

ii. *Mbledhja e të dhënave*

Mbledhja e të dhënave të sakta dhe të detajuara është thelbësore për analizën e suksesshme të nevojave gjinore. Të dhënat duhet të përfshijnë si informacion cilësor, ashtu edhe sasior, me qëllim që të maten të gjitha aspektet e pabarazisë gjinore në një shoqëri apo sektor, si dhe të identifikohen kushtet, prirjet dhe ndikimet aktuale. **Për analizën me bazë gjinore, janë të rëndësishme si të dhënat sasimore të ndara sipas gjinisë,¹² ashtu edhe të dhënat cilësore.** Të dyja llojet e të dhënave janë të nevojshme për të shqyrtuar balancën gjinore ekzistuese brenda një konteksti apo sektori.

Pyetjet specifike që duhet të adresohen në këtë fazë janë:

- *Disponueshmëria* – Çfarë të dhënash të ndara sipas gjinisë ekzistojnë në atë sektor? Çfarë cilësie kanë këto të dhëna?
- *Analiza* – A tregojnë të dhënat dallime gjinore ose ndërveprime gjinore sipas këtyre elementëve socio-ekonomike: mosha, arsimi, origjina etnike, përkatësia

12 Informacioni i ndarë sipas gjinisë do të thotë se numërojnë burrat dhe gratë veçmas kur mbledhin informacion për aktivitetet dhe përfitimet. Të dhënat e ndara sipas gjinisë janë të rëndësishme, sepse ndihmojnë për të vlerësuar nëse një nismë arrin të trajtojë dhe të sjellë përfitime për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë siç synohet. Treguesit duhet të specifikojnë që të gjitha të dhënat për grupet apo përfituesit e synuar duhet të ndahen sipas gjinisë. Informacioni mund të ndahet në disa ndryshore, në varësi të nismës, grupit të synuar dhe kontekstit, si p.sh. grupi socio-ekonomik, përkatësia etnike, raca, feja, aftësia e kufizuar dhe vendndodhja (rurale ose urbane).

në një pakicë kombëtare, statusi martesor dhe familjar, grupi i të ardhurave, aftësia e kufizuar apo ndonjë tjetër.

- *Nevoja për të dhëna shtesë* – Çfarë të dhënash të ndara sipas gjinisë duhet të mbledhen? Kush mund t'i mbledhë? Sa është kostoja e mbledhjes së tyre?

Për shembull, **këto lloje të dhënash mund të jenë të dobishme për një analizë nevojash me bazë gjinore në sektorin e arsimit:**

- **Të dhënat arsimore të ndara sipas gjinisë** duhet të përfshijnë informacion si: regjistrimi në shkollë, qëndrimi dhe përqindjet e përfundimit/diplomimit në sistemin parashkollor, 9-vjeçar, të mesëm dhe të lartë. Në punë hyn edhe mbledhja dhe analizimi i të dhënave për çështje më të gjera në lidhje me aksesin në arsim dhe arritjet në arsim, si p.sh. distanca ndërmjet shkollës dhe shtëpisë së fëmijët, mjetet e transportit dhe përdorimi i tyre nga djemtë dhe vajzat, masat e ndërgjegjësimit prindëror për mundësitë arsimore, si edhe përqindja e të rriturve që dinë shkrim dhe këndim. Cilësia e shkollës, statusi socio-ekonomik i familjeve, kufizimet rajonale për pasjen e mësuesve të kualifikuar, barrierat shëndetësore dhe ushqyerja duhet të merren parasysh dhe të maten, sa më shumë të jetë e mundur, në nivel shkolle, komuniteti, rajonal dhe/ose kombëtar.
- **Po aq të rëndësishme janë edhe të dhënat cilësore për mjedisin shkollor dhe komunitetin ku rritet fëmija.** Mjedisi shkollor ku ndodh dhunë, diskriminim apo ngacmim me bazë gjinore, nuk është i sigurt për nxënësit, as nxitës për të nxënit e tyre. Gjithashtu, është e rëndësishme të kuptohet nëse vajzat dhe djemtë orientohen drejtpërdrejt ose tërthorazi në disa fusha studimi specifike (p.sh. shkencat shoqërore për vajzat, shkencat e natyrës për djemtë), përmes programeve shkollore që ofrohen apo faktorëve të tjerë.
- Analistët gjinorë duhet të mbledhin **informacion edhe për faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë në aftësinë e vajzave apo djemve për të pasur akses në arsim**, qofshin fizike, psikologjike apo kulturore. Për shembull, të dhënat për moshën mesatare kur vajzat martohen dhe lindin fëmijë ose për vajzat me akses në produktet higjienike, mund të ofrojnë një panoramë të shkaqeve potenciale për mungesat apo braktisjet e zgjatura të shkollës. Të dhënat për shëndetin riprodhues dhe seksual, përfshirë shkallën e infektimit me HIV/AIDS, informacionin për moshën e marrëdhënive të para seksuale dhe statistikat për shëndetin amësor mund të jenë të dobishme për të përcaktuar shkaqet bazë të pabarazive gjinore, sepse pasqyrojnë faktorët e sektorit të shëndetësisë që prekin arsimin. Nga ana tjetër, djemtë mund të përballen me presionin negativ të bashkëmohatarëve, që të mos mësojnë

shumë apo aq mirë sa vajzat. Në mjediset e varfra dhe urbane, presioni për të lënë shkollën dhe për të filluar punë mund të prekë më shumë djemtë.

Kutia 1. Burimet e mbledhjes së të dhënave

Për mbledhjen dhe klasifikimin e të dhënave mund të përdoren një sërë burimesh, si bazat e të dhënave ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore që mirëmbahen nga qeveritë dhe autoritetet statistikore të tyre, organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe organizatat e ndihmës. Studimi i botuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) përmban një listë të disa bazave të të dhënave dhe indekseve në dispozicion që mund të përdoren si burime për kërkime mbi barazinë gjinore, "Instrumenti: Treguesit për Matjen e Rezultateve mbi Barazinë Gjinore".⁽¹⁾ Ky studim përmban edhe anketa demografike dhe shëndetësore, bazat e të dhënave të punës dhe ligjeve të punësimit dhe të dhëna të të drejtave të njeriut, si dhe tregues që mund të përdoren për të matur barazinë gjinore në sektorë të ndryshëm. Më poshtë gjeni disa nga këto burime të dhënash:

- **OECD, Gender, Institutions, and Development Database:** 60 variabla institucionale në bazën e të dhënave, që variojnë nga sjellja brenda familjes deri te normat sociale;
- **ILO Database of Conditions of Work and Employment Laws:** baza e të dhënave jep legjislacionin për mbrojtjen e mëmësisë, pagat minimale dhe orët e punës. Aty paraqiten tekste dhe interpretime.

- **ILO Key Indicators of the Labour Market:** të dhëna në rang kombëtar për 20 treguesit kyç të tregut të punës që nga viti 1980;
- **UNAIDS:** të dhëna ankete për epideminë globale AIDS;
- **UNDP, Gender Development Index:** indeks për treguesit që lidhen me gjininë;
- **UN Economic Commission of Europe (UNECE) Gender Statistics:** të dhëna nga agjenci kombëtare statistikash të grumbulluara nga UNECE;
- **UNStats:** 60 tregues për matjen e progresit drejt Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit;
- **Banka Botërore, GenderStats:** përpilim të dhënash në rang kombëtar në lidhje me çështjet gjinore, të përgatitura nga agjencitë kombëtare statistikore, bazat e të dhënave të Kombeve të Bashkuara, dhe anketat e kryera apo të financuara nga Banka Botërore;
- **Banka Botërore, Gender Law Library:** bazë të dhënash me dispozita ligjore kombëtare që prekin statusin ekonomik të grave.
- **Banka Botërore, Women, Business, and the Law:** këta tregues u krijuan mbi bazën e burimeve të kodifikuara të legjislacionit të brendshëm, si kushtetutat, kodet e familjes dhe martesës, kodet e punës, procedura pasaporte, rregulla shtetësie, statute trashëgimie, rregullore tatimore, ligje për tokën dhe kode të sigurimeve shoqërore, si edhe nga përgjigjet e praktikuesve në vende të ndryshme. Të dhënat janë mbledhur drejtpërdrejt nga teksti i ligjeve; dhe
- **Forumi Botëror për Zhvillim, Global Gender Gap Index:** indeks i ideuar për të matur boshllëqet gjinore në aksesin në burime dhe mundësi, në vende të ndryshme, bazuar në katër dimensionet. Treguesit janë marrë nga një sërë burimesh.

1 Informacioni i ndarë sipas gjinisë nënkupton numrin e burrave dhe grave veçmas kur mbledhin informacion për aktivitetet dhe përfitimet. Të dhënat e ndara sipas gjinisë janë të rëndësishme, sepse ndihmojnë për të vlerësuar nëse një nismë arrin të trajtojë dhe të sjellë përfitime për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë siç synohet. Treguesit duhet të specifikojnë që të gjitha të dhënat për grupet apo përfituesit e synuar duhet të ndahen sipas gjinisë. Informacioni mund të ndahet në disa ndryshore, në varësi të nismës, grupit të synuar dhe kontekstit, si p.sh. grupi socio-ekonomik, përkatësia etnike, raca, feja, aftësia e kufizuar dhe vendndodhja (rurale ose urbane).

Sapo përfundon mbledhja e të dhënave, duhet të fillojë vlerësimi i cilësisë dhe gjithëpërfshirjes. A janë të mjaftueshme të dhënat e disponueshme për të vlerësuar balancën gjinore ekzistuese dhe nevojat praktike dhe strategjike të nëngrupeve të ndryshme gjinore? Nëse të dhënat nuk janë adekuate, mund të duhet të përdoren mjete dhe sondazhe të veçanta (p.sh. një studim familjar në një zonë të caktuar) për të përfunduar mbledhjen e të dhënave.

iii. *Angazhimi me palët e interesuara*

Konsultimi i palëve të interesuara për nevojat e tyre mund të kontribuojë dhe të thellojë analizën me bazë gjinore, sepse peshohen dhe zgjerohen këndvështrime, sugjerohen alternativa politikash, pasurohen dhe akordohen planet legjislative dhe ato të politikave. Konsultimi mund të shërbejë edhe për identifikimin e treguesve të përshtatshëm për monitorim dhe ndjekje. Palët e interesuara mund të japin ide se si të forcohen dhe të promovohen objektivat e barazisë gjinore. Zbutja e ndikimeve negative të pabarazive ekzistuese duhet të hulumtohet përmes një procesi pjesëmarrës dhe konsultativ.

Palë të interesuara mund të jenë si vijon:

- **Përfituesit e mundshëm të ligjit** – Në sektorin e arsimit, p.sh. drejtorët e shkollave, mësuesit, përfaqësuesit e shoqatave prindër-mësues dhe studentët. Proceset e vendimmarrjes publike me këto palë të interesuara mund të organizohen në formën e konsultimeve publike, forumeve të diskutimit online ose me mënyra të tjera.
- **Përfaqësuesit e qeverisë** – Deputetë dhe përfaqësues të agjencive shtetërore që do të angazhohen në zbatimin e ligjit.
- **Shoqëria civile, akademikët dhe media** – Në punën me palët e interesuara, është thelbësore të krijohet bashkëpunim i mirë me shoqërinë civile dhe organizatat e të drejtave të njeriut me ekspertizë gjinore. Organizatat feministe dhe të grave janë prioritet, sepse ato kontribuojnë në forcimin e perspektivës gjinore që nevojitet gjatë procesit. Në këtë proces duhet të përfshihen edhe akademikët dhe Think Tank-et që punojnë me problematika të ngjashme, si edhe gazetarët që mbulojnë sektorin përkatës.

Proceset e vendimmarrjes publike mund të organizohen në mënyrë të hapur dhe përfshirëse, si pjesë e komisioneve parlamentareve, grupeve parlamentare të grave ose rrjeteve të tjera (shih Pjesën IV për informacion të mëtejshëm). Ato mund ta mbahen edhe si pjesë e vizitave të deputetëve në zonat zgjedhore përkatëse, përmes takimeve të hapura me publikun apo konsultimeve online. Është e rëndësishme që këto mundësi konsultimi të afishohen/shpallen siç duhet

për të gjitha palët e interesuara, si edhe që të dëgjohet një gamë e gjerë zërash dhe këndvështrimesh.

iv. Bashkimi i pjesëve

Informacioni i grumbulluar gjatë procesit të mbledhjeve të të dhënave dhe konsultimi me palët e interesuara duhet të sistemohet dhe të analizohet, me qëllim që t'i përgjigjet disa prej pyetjeve të mëposhtme (të përshtatura sipas secilit sektor dhe fushe ligjvënëse):

- Cilat janë nëngrupet gjinore kryesore të synuara (p.sh. vajzat, djemtë, gratë e reja/burrat, adoleshentët, adoleshentët, prindërit beqarë, prindërit e punësuar, të moshuarit) në këtë sektor?
- Cilat janë pabarazitë ekzistuese midis grave dhe burrave (ose midis nëngrupeve të grave dhe burrave)?
- Cilat janë interesat, nevojat dhe prioritetet praktike dhe strategjike të secilit prej këtyre nëngrupeve?
- Cilat janë pengesat që nuk lejojnë përmbushjen e këtyre nevojave dhe prioritetëve për secilin nëngrup?

Edhe kur diskriminimi nuk është qartësisht i dukshëm, analiza gjinore duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë formave më të fshehta të pabarazive gjinore që mund të ekzistojnë. Për shembull, në arsim, ulja e pritshmërive për vajzat në lëndë si matematika dhe kimia/fizika mund të çojë në diferenca të theksuara në performancë. Kur vajzat nuk nxiten që të arrijnë rezultate të larta, qoftë me trajtim diskriminues në klasa apo tekste shkollore ose programe mësimore që pasqyrojnë stereotipa gjinore kufizuese, kjo pasqyrohet në performancë të ulët.

Për strukturimin e analizës gjinore, një qasje/metodë praktike është fokusimi te mospërputhjet dhe nevojat gjinore në nivel individual, institucional dhe politikash makro. Për ilustrim, jepet shembulli i mëposhtëm **i analizës së nevojave në kontekstin e aksesit në shërbimet financiare.**

Kutia 2. Aksesit në shërbime financiare nga gratë dhe burrat

Një projektligj që synon të lehtësojë aksesin në kredi për sipërmarrëset duhet të marrë parasysh konsideratat vijuese:

Nivelin individual - Gratë dhe burrat kanë nevoja të ndryshme kreditimi për gjenerimin e të ardhurave dhe skemave të tjera të zgjerimit. Zakonisht, gratë mbajnë paratë për sende shtëpiake të vogla, ndërsa burrat kontrollojnë të ardhurat për sende më të mëdha. Gratë shpesh nuk i dinë të drejtat e tyre kur aplikojnë për kredi, ose kanë më pak gjasa të kenë certifikata pronësie për prona kolateral. Gratë mund të ndihen të pasigurta me gjuhën financiare apo në bashkëveprimin me institucionet financiare, pasi burrat kanë më shumë gjasa të jenë pronarë të tokave apo kapitali të trupëzuar.

Nivelin institucional - Struktura e sistemit formal të kreditimit është zakonisht hierarkike dhe jo gjithmonë praktike. Shuma minimale e kredisë mund të jetë e lartë, pasi institucionet e kreditimit kanë të njëjtën kosto përpunimi si për kreditë e mëdha, ashtu edhe për ato të vogla. Në disa rajone, mund të jenë kryesisht meshkujt të

punësuar në sistemin formal të kreditimit, ndërsa gratë mund të konsiderohen të papërshtatshme që të merren me bankat. Burimet joformale të kreditimit janë shpesh përmes huadhënësve, të cilët mund të preferojnë të merren me kryefamiljarët meshkuj. Informacioni rreth sistemeve të kreditimit qarkullon përmes medias dhe fjalës së gojës. Gratë sipërmarrëse që kanë biznes të vogël, mund ta kenë më të vështirë të marrin kredi, sepse shpesh përballen me paragjykime, pasi nuk shihen si sipërmarrëse "serioze" ose nuk konsiderohen "serioze" nga institucionet financiare.

Nivelin e politikave - Rregullimi i shtetit nuk i lejon institucionet financiare t'u japin kredi individëve që nuk zotërojnë kapital të trupëzuar, p.sh. fermerët. Edhe pse qeveritë mund të synojnë të promovojnë sipërmarrjen, duket se ka pengesa që nuk iu mundësojnë institucioneve shtetërore të ofrojnë hua. Shpesh nuk ka kanale shtesë për t'u ofruar hua apo kredi të vogla individëve me historik të mirë kreditimi.

Burimi: Moduli për Integrimin Gjinor: Qasje dhe Metodologji, (Turin: ITC/ILO, Gender Campus, Turin, 2006).

Kjo analizë e situatës tregon që gratë kanë disa nga nevojat e mëposhtme:

- **Nevojat praktike** të grave përfshijë krijimin e kanaleve që të aplikojnë për hua të vogla përmes programeve shtetërore të dedikuara apo nismave joshtetërore, ofrimin e informacionit më të aksesueshëm mbi opsionet e kreditimit dhe thjeshtimin e aplikimeve për hua/kredi.
- **Nevojat strategjike** përfshijnë promovimin e idesë së grave sipërmarrëse në shoqëri dhe rritjen e nivelit të pranimit të shoqërisë për gratë sipërmarrëse. Ato përfshijnë edhe përpjekjet me institucionet financiare për parandalimin e diskriminimit të hapur ose të fshehtë të grave, shqyrtimin e reformave që rrisin përfitueshmërinë për institucionet financiare që japin hua të vogla, si edhe eksplorimi i alternativave ndaj kritereve tipike për kolateral.

Hapi 2: Vlerësimi i ndikimit gjinor të një ligji specifik

Informacioni i mbledhur nga analiza e nevojave dhe konsultimi me palët e interesuara duhet të analizohet tërësisht **për të vlerësuar ndikimin konkret gjinor të ligjit në fjalë**. Ky hap i analizës LNGj zhvendoset nga niveli i sektorit të implikimet gjinore të një projektligji ose ligji të caktuar. Një rregull i thjeshtë në këtë kontekst është se sa herë që një ligj synon “njerëz” (qytetarë, fëmijë, të moshuar, punonjës, sipërmarrës, etj.), rrjedhimisht synon gra dhe burra, vajza dhe djem, kështu që ndikimi gjinor i tij duhet të ndahet dhe të vlerësohet.

Pyetjet kryesore që duhet të shqyrtohen në këtë fazë janë: Ligji ka ndikime të ndryshme te gratë dhe burrat (p.sh. kriteret e pranueshmërisë, niveli i përfitimeve, aksesueshmëria, disponueshmëria e aktiviteteve mbështetëse, etj.)? Si, pse dhe deri në çfarë mase? (Kutia 3 jep disa pyetje të dobishme që mund të përfshihen në vlerësim).

Ndikimi gjinor mund të vlerësohet duke analizuar aspektet e mëposhtme:

- **Identifikimi i përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë** - Cilët janë përfituesit e synuar të një ligji? Sa gra dhe burra (dhe nëngrupeve të grave dhe burrave) do të përfitojnë nga ligji (p.sh. nga shërbimet e ofruara, infrastruktura e ndërtuar, transfertat monetare, etj.) dhe si? Sa gra dhe burra do të përballen me implikime negative për shkak të ligjit dhe pse?
- **Matja e ndikimit** – Cilët janë objektivat afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të legjislacionit dhe cilat janë ndikimet e synuara të nëngrupeve të ndryshme të grave dhe burrave? A pritet që ligji të thellojë apo të pakësojë ndonjë pabarazi ekzistuese (bazuar në analizën e nevojave gjinore më lart) dhe, nëse po, si?

Një komponent kyç i matjes së ndikimit është analiza e “4 R-ve”¹³, që i referohet pabarazive ndërmjet grave dhe burrave për sa i përket përfaqësimit, burimeve, të drejtave dhe realiteteve. Në këtë aspekt, mund të mbahen parasysh këto aspekte:

- *Përfaqësimi* – ndikimi i ligjit te përbërja gjinore e popullatës së synuar dhe te përfaqësimi i grave dhe burrave në pozicionet vendimmarrëse;
- *Burimet* – ndikimi i ligjit në shpërndarjen e burimeve thelbësore, si koha, hapësira, informacioni dhe paraja, pushteti politik dhe ekonomik, arsimi dhe

13 Shënim i përkthyesit: 4 R-të: Representation, Resources, Rights, Realities

formimi profesional, pozicionet e punës dhe karriera profesionale, teknologjitë e reja, shërbimet e kujdesit shëndetësor, strehimi, mjetet e transportit dhe koha e lirë;

- *Të drejtat* – ndikimi i ligjit të diskriminimi i hapur apo i fshehtë me bazë gjinore, të drejtat e njeriut (përfshirë lirinë për mbrojtje nga dhuna seksuale dhe poshtërimi) dhe aksesin në drejtësi, në mjedisin ligjor, politik apo socio-ekonomik; dhe
- *Realitetet* – ndikimi i ligjit të objektivat gjinore aktuale dhe të perceptuar, ndarja e punës sipas gjinisë, sjelljet dhe qëndrimet e grave dhe burrave, mbizotërimi i stereotipave mashkullore dhe femërore.

Kutia 3. Pyetje të posaçme për të vlerësuar ndikimin e legjislacionit të gratë dhe burrat

Pyetje të përgjithshme – E promovon ligji barazinë mes grave dhe burrave? A i trajton ligji gratë dhe burrat de facto njësoj? A janë identifikuar në mënyrë adekuate nevojat dhe rrethanat e veçanta të grave dhe burrave? A nevojiten masa të posaçme për gratë ose burrat? A e cenon ligji perspektivën afatgjatë për realizimin e barazisë gjinore?

Vendimmarrja – A shkakton ligji pasojë të ndryshme të mundësitë e grave dhe burrave që të marrin pjesë dhe të ndikojnë në vendime? A i forcon ligji mundësitë si për gratë ashtu edhe për burrat që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje në të gjitha fushat?

Statusi ekonomik – A ka ligji efekte të ndryshme në statusin ekonomik të grave dhe burrave? Cilat janë pasojat, p.sh. në lidhje me pagën, taksimin apo të ardhurat? A prekin ndryshimet e pritshme ekonomike, pozitive apo negative, më shumë gratë apo burrat?

Jeta profesionale – A e prek ligji pozitën e grave dhe burrave në tregun e punës në masë/mënyra të ndryshme? A ka ligji pasojë të ndryshme në lidhje me punësimin, kushtet e punësimit, pagën apo kushtet e punës në sektorë të dominuar përkatësisht nga gratë ose burrat? A nevojiten zgjidhje të posaçme për të garantuar statusin e grave apo burrave në tregun e punës, ose, p.sh. për të mbështetur

rekrutimin dhe avancimin e karrierës në atë sektor/fushë? A e forcon apo e dobëson ligji hendekun gjinor në fusha dhe profesione të ndryshme? A e mbështet ligji balancimin e punës dhe jetës familjare për punëmarrësit?

Biznesi dhe industria – A ka ligji pasojë të ndryshme të bizneset në fushat e dominuara prej grave ose burrave, apo në bizneset me përmasa të ndryshme? A i dobëson ligji mundësitë e sipërmarrjes për gratë apo për burrat? A nevojiten masa të posaçme për të mbështetur sipërmarrjet e grave?

Arsimimi – A mbështet ligji mundësi arsimimi dhe zhvillim profesional si të grave ashtu edhe të burrave, pavarësisht sektorit profesional apo arsimor? A nevojiten zgjidhje të veçanta për të mbështetur mundësitë për arsimin e vajzave, djemve, grave apo burrave?

Prindërimi – A mbështet ligji si gratë edhe burrat, në prindërim dhe në krijimin e familjes? A prek ligji ndryshe prindërit që kanë fëmijë nën kujdestari, e ndryshe ata që nuk kanë? A e nxit ligji shpërndarjen e barabartë të lejes prindërore (të lindjes) dhe ndarjen e përgjegjësisë të përkujdesjes mes grave dhe burrave? A nevojiten masa të veçanta për të forcur lejen prindërore apo përgjegjësitë prindërore?

Shërbimet publike – A janë të ndryshme pasojat për burrat dhe gratë në lidhje me aksesin në shërbimet dhe asistencën e nevojshme? A nevojiten modalitete të veçanta për të garantuar që si gratë, edhe burrat, të marrin këtë asistencë dhe shërbime?

Mirëqenia dhe shëndeti – A ka ligji ndikim të ndryshëm në shëndetin mendor dhe fizik apo në mirëqenien mes grave dhe burrave? A janë marrë në konsideratë dallimet në faktorët e riskut për shëndetin dhe mirëqenien e grave dhe burrave? A i pakëson ligji mospërputhjet shëndetësore mes grave dhe burrave, ose brenda grupit përkatës? A e forcon ligji pjesëmarrjen sociale dhe mirëqenien si të grave, ashtu edhe të burrave?

Siguria – A ka ligji efekte të ndryshme për sigurinë e perceptuar nga gratë dhe burrat? A merr parasysh ligji rreziqet e ndryshme të sigurisë për gratë dhe burrat në shtëpi, punë dhe gjatë kohës së lirë? A nevojiten masa të veçanta për të pakësuar dhunën ndaj grave?

Ambienti rrethues dhe kushtet e jetesës

– A ndikon ligji te kushtet e jetesës apo jeta e përditshme e grave dhe burrave në masë/ mënyra të ndryshme? A merr parasysh ligji nevojat si të grave, edhe të burrave, në lidhje p.sh. me strukturat e komunitetit, planifikimin e transportit apo aksesueshmërinë?

Koha e lirë – A promovon ligji mundësitë si të grave edhe të burrave për kohë të lirë dhe ushtrimin e hobeve? A mbështeten njësoj shërbimet kulturore dhe sportive për gratë dhe burrat?

Burimi. Syzet Gjinore në përdorim: Manual në mbështetje të punës për barazinë gjinore në ministrinë finlandeze, (Helsinki: Ministria finlandeze e Punëve Sociale dhe Shëndetësisë), <<http://julkaisut.valtioneuvosto.fi/handle/10024/74721>>.

Hapi 3: Integrimi i aktiviteteve me fokus gjinor në një projekt ligj

Duhet të përgatiten aktivitete specifike që synojnë fusha apo çështje të caktuara në lidhje me barazinë gjinore brenda ligjit, nëse kjo është e mundur për sektorin apo ligjin në fjalë. Çështja kryesore është se si ligji mund të kontribuojë në eliminimin e pabarazive ekzistuese dhe të promovojë barazinë ndërmjet grave dhe burrave: në përqindjet e pjesëmarrjes, shpërndarjen e burimeve, përfitime, detyrave dhe përgjegjësi në jetën private dhe publike, si edhe në perceptimin e roleve, sjelljes dhe prioriteteve gjinore?

Në **legjislacionin për arsimit**, p.sh. këto aktivitete mund të përfshijnë programe holistike të zhvillimit dhe kujdesit për fëmijërinë e hershme, ndryshime në programe mësimore (kurrikula) për të rrëzuar stereotipat, trajnime për mësuesit që të rrisin ndjeshmërinë gjinore në klasë dhe të krijojnë mjedise mësimore më të sigurta, përpjekje për të angazhuar djemtë dhe burrat në edukim, programe mësimore në distancë për gratë që nuk mund të frekuentojnë mësimin për shkak të angazhimeve familjare apo të tjera.

Është e rëndësishme të theksohet se **aktivitetet me fokus gjinor nuk duhet “të futen me zor” në legjislacion, kur ky nuk ka implikime gjinore.** Nëse analiza gjinore e shpjeguar më lart nuk evidenton ndikime ligjore me aspekt gjinor, atëherë konsideratat gjinore nuk duhet të integrohen apo të futen në mënyrë artificiale. Pra, aktivitetet me fokus gjinor përgatiten kur ato përshtaten natyrshëm me objektivat dhe objektin e ligjit në fjalë.

Hapi 4: Krijimi i treguesve për matjen e ndikimit të mundshëm gjinor

Hapi i fundit i analizës LNGj është ngritja e një kuadri për monitorimin dhe vlerësimin e ligjeve dhe politikave. Çështjet gjinore duhet të merren parasysh në të gjitha raportet e progresit dhe raportet e performancës që vlerësojnë ndikimet e ligjit në fjalë.

Kjo fazë e analizës LNGj duhet të arrijë dy objektiva. Së pari, **identifikoni treguesit** që matin ndikimet gjinore të ligjit. Së dyti, **hartoni një kuadër rregullator** që ngarkon organe shtetërore apo grupe të shoqërisë civile me **monitorimin e zbatimit të secilit tregues.**

Treguesit me ndjeshmëri gjinore mund të jenë sasiorë ose cilësorë:

- **Treguesit sasiorë** nevojiten për të treguar në çfarë mase është arritur një objektivi, ose rezultatin mesatar. Burimet e treguesve sasiorë janë sisteme të dhënash ku informacioni paraqitet i ndarë sipas seksit. Konkretisht, këto burime janë: regjistrime popullore (censuse), anketa të fuqisë punëtore, të dhëna administrative ose anketa sociologjike të popullatës së synuar. Treguesit sasiorë janë më të lehtë për t'u përkufizuar, regjistruar dhe vlerësuar, sesa treguesit cilësorë.

Për shembull, një tregues sasior me ndjeshmëri gjinore është numri i vendeve të punës të reja të krijuara përkatësisht për gratë dhe burrat në sektorin e biznesit të vogël, si rezultat i fokusit shtetëror në këtë sektor.

- **Treguesit cilësorë** përfshijnë gjykimet dhe perceptimet e njerëzve për një temë të caktuar. Ato shërbejnë për të kuptuar proceset, por shpesh nuk tregojnë se sa tipike apo të përhapura janë këndvështrimet e shprehura. Treguesit cilësorë janë më të vështirë për t'u matur, sepse shqyrtojnë procese dhe kategori klasifikimesh, si ato të bazuara në perceptime. Për shembull, treguesit cilësorë mund të tregojnë ndryshimet në qëndrime dhe sjellje; shtim të dijeve dhe aftësive, vetëbesim, pavarësi ose vetëvlerësim; si dhe progresin në vendosjen e kontakteve, formimin e rrjeteve apo krijimin e mekanizmave për mbështetje sociale. Burimet tipike të treguesve cilësorë janë dëgjuesat publike, fokus grupet, anketat e qëndrimeve dhe intervistat, vlerësimet pjesëmarrëse, vëzhgimi i pjesëmarrësve, si edhe puna sociologjike dhe antropologjike në terren.

Për shembull, një tregues cilësor me ndjeshmëri gjinore është niveli i besimit dhe miratimit që gratë dhe burrat kanë për legjislacionin që i përket të drejtës së familjes, i vlerësuar përmes intervistave.

Kurdo që është e mundur, treguesit e barazisë gjinore duhet të hartohen përmes një procesi pjesëmarrës me palët e interesuara kyçe. Ky parim është i vërtetë për të gjithë treguesit, por është edhe më e rëndësishme për barazinë gjinore, sepse në këtë rast vlerësohen ndryshimet në marrëdhëniet gjinore në një shoqëri, të cilat bazohen në besime thellësisht të konsoliduara për sjelljet dhe normat shoqërore. Gratë dhe burrat shpesh kanë perceptime dhe përvoja të ndryshme të marrëdhënieve gjinore - përfshirë rolet dhe përgjegjësitë me bazë gjinore, modelet e vendimmarrjes, pikëpamjet se si po ndryshojnë marrëdhëniet gjinore dhe shkaqet e këtyre ndryshimeve. Si gratë, edhe burrat, duhet të përfshihen në identifikimin e rezultateve dhe treguesve, si dhe në mbledhjen dhe analizimin e informacionit.

Shtojca 1 sugjeron shembuj të treguesve që mund të maten në sektorin e arsimit.

Implikimet financiare të LNGj-së: Analiza e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGj) është pjesë e rëndësishme e LNGj-së. Buxheti është instrumenti politik më i rëndësishëm për qeverinë, pasi ndikon në zbatimin e suksesshëm të të gjitha politikave të tjera. Buxhetet e përgjegjshme gjinore nuk janë buxhete të veçanta për burrat dhe gratë, por buxhete që garantojnë se nevojat dhe interesat e individëve nga grupe të ndryshme shoqërore (gjinia, mosha, raca, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar dhe vendndodhja) të trajtohen në politikatat e shpenzimeve dhe të të ardhurave. Si një mjet i menaxhimit të financave publike, analiza e buxhetimit të përgjegjshëm mundëson për të përcaktuar se si dhe deri në çfarë mase politika e shtetit ndikon në grupe të ndryshme të grave dhe burrave, si konsumatorë të shërbimeve, përdorues të infrastrukturës dhe taksapagues. Buxheti i përgjegjshëm gjinor përdor mjete, qasje dhe strategji të ndryshme për të monitoruar rezultatet, outputet, aktivitetet dhe inputet e buxheteve me perspektivë gjinore.

Më konkretisht, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor mundëson që përmes mekanizmave të tij

- Të rritet transparenca dhe llogaridhënia në procesin e përgjithshëm të buxhetit, duke u fokusuar se ku shkojnë shpenzimet dhe si përfitojnë prej tyre nëngrupe të ndryshme nga perspektiva gjinore;
- Të kuptohet më mirë ndikimi i shpenzimeve publike duke ndarë sipas gjinisë mënyrën se si alokimet buxhetore shpërndahen mes burrave dhe grave;

- Të garantohet që buxhetet të kontribuojnë në zbutjen e pabarazive mes grave dhe burrave dhe të mos i thellojë ato; si dhe
- Të trajtohen në mënyrë aktive shqetësimet specifike të lidhura me gjininë (p.sh., cilësia e ulët ose aksesit i ulët në kujdesin shëndetësor ose në arsim.

Kutia 4. Shembull i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në kujdesin për fëmijët

Një nga shembujt më efektivë të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor është financimi i programeve të kujdesit dhe zhvillimit të hershëm të fëmijës, nga të cilat përfitojnë gratë në mënyrë disproporcionale. Masa të tilla lehtësojnë gratë nga barra e kujdesit për fëmijën që mund t'i pengojë të ndjekin shkollën

ose të mbajnë një vend pune të qëndrueshëm. Këto masa mund të përfshijnë: alokimin e fondeve shtetërore për ngritjen e objekteve të reja të kujdesit ditor në të gjithë vendin, ose në zonat ku punësimi i grave është i ulët; përmirësimin e cilësisë së objekteve ekzistuese të kujdesit ditor; subvencionimin e kujdesit ditor për prindërit beqarë ose grupe të tjera shoqërore vulnerabël; fushata informuese për të familjarizuar prindërit me alternativat që eksitojnë në lidhje me kujdesin ditor.

Buxheti i përgjegjshëm gjinor funksionon më mirë kur institucionalizohet. Në disa parlamente, nismat për buxhetim të përgjegjshëm gjinor janë nxitur nga komisionet parlamentare (shih shembullin në Kutinë 5); në disa të tjera, është realizuar përmes bashkëpunimit mes parlamentit dhe institucioneve shtetërore dhe/ose joshtetërore (si në Afrikën e Jugut).¹⁴

14 “Nisma e Buxhetit të Grave: Afrika e Jugut”, Banka Botërore, 2010, <http://siteresources.worldbank.org/INTEMPowerment/Resources/14659_S-Afr-Wmn-Budg-web.pdf>.

Kutia 5. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në parlamentin suedez dhe atë austriak

Në parlamentin suedez, Komisioni i Financave merr në konsideratë gjininë kur merret me buxhetin e qeverisjes qendrore. Çdo vit, që nga viti 1988, një shtojcë e veçantë i është bashkëngjitur projektligjit të buxhetit, që tregon shpërndarjen e burimeve ekonomike midis gjinive. Shtojca tregon se si pabarazitë gjinore mes grave dhe burrave shprehen në terma ekonomikë (p.sh., shpërndarja e punës shtëpiake, punësimi fitimprurës, studimet, shpërndarja e të ardhurave, të ardhurat kapitale dhe përfitimet e sigurimeve shoqërore) dhe si sistemi i mirëqenies ndihmon në uljen e mospërputhjeve gjinore. Një praktikë e mirë e parlamentit suedez është se Komisioni i Financave ka kompetencën –përmes rregullave të përcaktuara dhe afateve të përshtatshme – që të analizojë dhe të diskutojë çdo zë shpenzimi me palët e interesuara në Parlament, agjencitë shtetërore dhe shoqërinë civile.

Burimet: “Europe: A Survey of Gender Budgeting Efforts”, Working Paper, WP/16/155, IMF, July 2016, <<https://www.imf.org/external/pubs/cat/longres.aspx?sk=44148.0>>; “Gender Budgeting in OECD countries”, OECD, June 2016, <<http://www.oecd.org/gov/budgeting/latestdocuments/>>.

Buxheti i përgjegjshëm gjinor u fut në Austri si pjesë e reformës së përgjithshme të buxhetit federal që udhëhiqej nga Ministria e Financave në vitin 2013. Si rezultat i reformës, të gjitha institucionet publike që kryejnë analiza buxheti kishin tagrin të adresonin çështjet gjinore si kategori më vete e analizës dhe kontrollit. Gjithashtu, reforma integroi barazinë gjinore në parimin e buxhetimit të orientuar drejt performancës. Mjeti kryesor metodologjik për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në Austri është identifikimi i objektivit të barazisë gjinore për secilin kapitull të buxhetit si element integral i buxhetimit të orientuar drejt performancës. Megjithatë, një dobësi e mundshme e metodës austriake është se ajo është një incentivë e integruar që kërkon identifikimin e objektivave relevantë dhe mundësisht transformues të barazisë gjinore. Vlerësimi i metodës në 2015-ën tregoi se personeli i buxhetit, edhe pse shprehu përkushtim ndaj objektivit të barazisë gjinore, nuk kishte kapacitetet e duhura për analizë gjinore të thelluar.

Burimi: “Europe: A Survey of Gender Budgeting Efforts”, Working Paper, WP/16/155, IMF, July 2016, <<https://www.imf.org/external/pubs/cat/longres.aspx?sk=44148.0>>.

Parlamentarët duhet të trajnohen që të kenë akses në informacion dhe të jenë në gjendje të analizojnë në mënyrë të pavarur ndikimin gjinor në buxhet. Përveç informacionit që marrin nga qeveria, parlamentarët duhet të kenë akses të pavarur në informacion, mundësisht përmes një shërbimi kërkimor të vetë parlamentit. Kjo mund të plotësohet me analiza nga think tank-e të pavarura, ekonomistë të sektorit privat dhe akademikë.

Pjesa IV. Metodrat për Institucionalizimin e LNGj-së

Për të qenë efektive, LNGj duhet të zbatohet brenda një kuadri institucional që lejon shqyrtimin periodik dhe sistematik me fokus gjinor të projektligjeve të propozuara dhe të ligjeve ekzistuese. Raporti i Unionin Ndërparlamentar të vitit 2011 Gender Sensitive Parliaments: A Global Review of Good Practice thekson tre parime madhore për institucionalizimin e barazisë gjinore në aktivitetet parlamentare¹⁵. Ato përfshijnë:

- Miratimin e strategjive për integrimin gjinor për të mundësuar që parlamenti si i tërë të konsiderojë të gjitha politikat dhe proceset e veta nga perspektiva gjinore. Kjo përfshin integrimin gjinor si në proceset, ashtu edhe në output-et e punës parlamentare. Zbatimi i efektshëm i kësaj strategjie kërkon që të gjithë deputetët ta kenë të qartë nevojën për barazinë gjinore dhe parimet e saj, si edhe mjetet për integrimin e saj në legjislacion.
- Ngritjen e infrastrukturës kushtuar barazisë gjinore, si p.sh. një komision parlamentar për barazinë gjinore, komisione shumëportofolëshe që kanë edhe përgjegjësinë për barazinë gjinore, një grup parlamentar deputetesh ose njësi që ofrojnë shërbime kërkimore. Këtyre organeve u besohet zakonisht monitorimi i progresit të integritimit gjinor në të gjithë parlamentin, shqyrtimin e aspekteve gjinore të të gjitha raportimeve qeveritare, si dhe efektivitetin e treguesve të performancës të përdorur për të monitoruar progresin.
- Forcimin e hallkave që mbrojnë barazinë gjinore jashtë parlamentit dhe garantimin e komunikimit periodik dhe të institucionalizuar.

15 Gender Sensitive Parliaments: A Global Review of Good Practice (Geneva: Inter-Parliamentary Union, 2011) <<http://www.ipu.org/pdf/publications/gsp11-e.pdf>>.

Më poshtë paraqiten disa praktika të mira globale në lidhje me zbatimin e secilit prej këtyre parimeve.

(a) Miratimi i një strategjie veprimi LNGj

Shumica dërrmuese e shteteve anëtare të OSBE-së kanë dispozita kushtetuese dhe legjislative që adresojnë barazinë gjinore. Këto dispozita luajnë rol të rëndësishëm, por integrimi i LNGj-së kërkon miratimin e një kuadri veprimi LNGj që mundëson ngritjen e një makinerie për barazinë gjinore në qeveri, përcakton parimet kryesore dhe përvijon ndarjen e punës mes njësive të ndryshme të qeverisë. Kështu, **për të lehtësuar analizën e nevojave për LNGj, është e nevojshme të bëhet dallimi mes barazisë gjinore në letër dhe integrimit gjinor në praktikë.**

Faktorët që tregojnë institucionalizimin e integrimit gjinor janë si më poshtë:

- A është hartuar dhe/ose miratuar një ligj që garanton mundësi të barabarta për gratë dhe burrat?
- A është i parashikuar me ligj krijimi i mekanizmave apo institucioneve për të siguruar barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut për gratë?
- Cili është roli zyrtar i mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore brenda qeverisë? A ka ndonjë fuqi vendimtare apo është rol kryesisht këshillues?

Faktorët që duhen marrë parasysh në vlerësimin e barazisë gjinore dhe integrimin në praktikë janë si më poshtë:

- A kanë rezultuar ligjet për mundësi të barabarta në politika gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar dhe/ose vendor? (p.sh. në rregulloret dhe udhëzimet për sigurimin e mundësive të barabarta, në miratimin e perspektivës së barazisë gjinore, në krijimin e mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit)?
- A funksionon në praktikë ndonjë politikë e integrimit të perspektivës së barazisë gjinore (d.m.th., a janë mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat pjesë integrale e politikës së qeverisë)?
- A kanë institucionet apo mekanizmat e barazisë gjinore të përcaktuara me ligj statute, buxhete dhe burimet adekuate të pavarura?

- Cili organ është përgjegjës për shqyrtimin e legjislacionit nga perspektiva gjinore? A duhet të krijohet një organ i ri, apo këtë detyrë mund ta ndërmarrë një organ ekzistues?
- Çfarë burimesh apo mjetesh i duhen organit për të përmbushur mandatin e tij?
- A ka infrastrukturë dhe burime të mjaftueshme për të marrë përgjegjësinë për kuadrin e integritit të perspektivës gjinore, si një komision me kompetenca të përshtatshme për të monitoruar zbatimin e ligjit dhe alokimet e duhura buxhetore?
- A janë ndërmarrë nisma ndërgjegjësimi publik për të edukuar publikun për nevojën e një ligji për mundësi të barabarta ose masa të tjera të përkohshme të veçanta për të eliminuar diskriminimin?
- A janë qytetarët të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, ligjet dhe institucionet e ngritura për të promovuar dhe mbrojtur ata?

Për të qenë efektiv dhe i qëndrueshëm, LNGJ duhet të ekzistojë si në letër, ashtu edhe në praktikë. Më poshtë jepen disa shembuj të strategjive LNGJ që përfshijnë dispozita dhe kërkesa specifike për të garantuar që barazia gjinore të integrohet në legjislacion:

- Në **Spanjë**, *Ligji për Barazinë 2017* fokusohet në të drejtën e barabartë për punë, për pjesëmarrje politike dhe për karrierë në sektorin publik. Në këto fusha, ligji përcakton veprime dhe politika të detyrueshme dhe pozitive, të tilla si Plane Strategjike të Shanseve të Barabarta, krijimin e një Komisioni Ndërmnistror për Barazinë, përfshirjen e raporteve të ndikimit gjinor në çdo ligj ose plan kombëtar, si dhe raporte periodike mbi efektivitetin e ligjit;
- Në **Belgjikë**, *Akti i Integritit Gjinor 2007* garanton, ndër të tjera, që objektivat strategjike të barazisë gjinore të përcaktohen për çdo politikë të re. Ligji gjithashtu kërkon që çdo projektligj i ri apo politikë e propozuar të kalojë një **“test gjinor”**, pasi qeveria federale duhet të përcaktojë **objektivat strategjike për barazinë gjinore** në fillim të aktit legjislativ për çdo fushë politikash nën përgjegjësinë e saj. Akti gjithashtu parashikon **ndjekjen dhe vlerësimin** e këtyre veprimeve. Ministrat duhet të përcaktojnë treguesit gjinorë për të matur arritjen e objektivave strategjike të përcaktuara dhe të paraqesin raporte vjetore mbi veprimet, masat dhe projektet e kryera në përmbushje të këtyre objektivave strategjike. Pengesat dhe masat korrigjuese duhet të përfshihen në raportet e ndërmjetme. Gjithashtu, progresi i

përgjithshëm duhet të matet në bazë të pozitës relative shoqërore të grave dhe burrave në fillim dhe në fund të aktit legjislativ;

- Në **Austri**, reforma e buxhetit federal në 2013-ën parashikon analizë të ndikimit rregullator të barazisë “efektive” mes burrave dhe grave, si dhe vlerësim të ndikimit gjinor të të gjitha ligjeve, rregulloreve dhe direktivave të reja, po ashtu edhe të projekteve të mëdha qeveritare.

Si përfundim, **një strategji e suksesshme LNGj duhet të jetë pjesë e një kuadri ligjor të dedikuar dhe formal** - qoftë një ligj specifik për barazinë gjinore apo legjislacion më të përgjithshëm për të drejtat e njeriut - që përfshin modalitete konkrete institucionale për organet që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e analizës me bazë gjinore (p.sh., një komision ndërministror), për mandatin dhe funksionet e tyre, si dhe për rezultatet specifike të analizës gjinore (p.sh., testet gjinore, treguesit gjinorë etj.). Gjithashtu, është thelbësore që këto modalitete institucionale të shoqërohen me alokime të përshtatshme buxheti që u mundëson institucioneve zbatuese funksionimin e duhur.

(b) Ngritja e infrastrukturës për LNGj

Hap thelbësor për institucionalizimin e LNGj-së është ngritja e infrastrukturës së dedikuar për LNGj-në. Që nga nëntori 2016, Unioni Ndërparlamentar (IPU) ka regjistruar 151 organe parlamentare që merren me barazinë gjinore në 123 vende¹⁶. Këto organe janë komisione parlamentare, grupe deputetesh, njësi teknike gjinore ose shërbime kërkimore.

Organet parlamentare me fokus barazinë gjinore ndryshojnë ndjeshëm në organogramë, strukturë, aktivitete dhe shkallë formaliteti. Disa struktura, si grupet ndërpartiake të deputeteve, njihen si forume të rëndësishëm për përfaqësimin e interesave të grave përtej politikës partiake¹⁷. Komisionet parlamentare janë mekanizma më formalë që mundësojnë deputetët dhe deputetet të ndikojnë në agjendat ligjvënëse dhe ato të politikave, si përmes garantimit të ndjeshmërisë gjinore gjatë shqyrtimit të projekt-akteve, por edhe përmes kërkimeve rreth çështjeve të barazisë gjinore.

16 Unioni Ndërparlamentar, databaza PARLIME për parlamentet kombëtare, <<http://www.ipu.org/parline-e/parlinesearch.asp>>.

17 Për organet parlamentare të grave që promovojnë barazinë gjinore dhe përfaqësimin e grave, shih Studim Krahasues i Strukturave për Gratë Deputete në Rajonin e OSBE-së (Varshavë: ODIHR, 2013), <<http://www.osce.org/odihr/105940>>.

i. Komisione të posaçme për barazinë gjinore

Strategjitë e efektshme LNGj përfshijnë mekanizma që kanë për synim t'u kërkojnë llogari qeverive për integrimin e perspektivës së barazisë gjinore. Kjo është në përputhje me Platformën për Veprim të Pekinit, e cila thekson se qeveritë duhet të raportojnë “rregullisht pranë organeve legjislative mbi progresin e përpjekjeve, sipas rastit, për integrimin e perspektivës së barazisë gjinore”.

Parlamentet luajnë një rol kryesor në integrimin e LNGj-së, duke krijuar komisione të posaçme për barazinë gjinore. Këto janë organe parlamentare të përhershme, me rregullore të brendshme, me anëtarësim që pasqyron përfaqësimin e partive politike (ose të grupeve parlamentare) në parlament. Komisionet e posaçme të barazisë gjinore janë krijuar në më shumë se 30 vende të botës.

Funksionet e këtyre komisioneve përfshijnë:

- **Kryerjen e analizës me bazë gjinore të legjislacionit dhe monitorimin e ndikimit gjinor të ligjeve ekzistuese;**
- **Krijimin e një rrjeti të pikave fokale gjinore në të gjithë komisionet e Kuvendit dhe punë në partneritet me mekanizmat kombëtarë të grave, shoqërinë civile, OJQ-të, sektorin privat dhe median, për të garantuar ndjekje, shqyrtim dhe mbikëqyrje parlamentare;**
- **Mbajtjen e dëgjësive publike për të përcaktuar ndikimet e ligjeve, politikave dhe programeve te gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë. Ministrat dhe zyrtarët mund të thërriten para komisionit që t'u përgjigjur pyetjeve;**
- **Lëshimin e dokumenteve ose përgatitjen e raporteve, përfshirë rekomandime për masa që**

Në Francë, Taks Forca për të Drejtat e Grave dhe Mundësitë e Barabarta për Burrat dhe Gratë në Senat dhe në Kuvendin Kombëtar harton raporte publike me rekomandime për projekt-aktet. Task Forca propozon edhe se si të forcohet ndikimi gjinor i legjislacionit dhe akteve normative në fushat që ka nën kompetencë.

Në Austri, Komisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore shqyrton ndryshimet ligjore në lidhje me gjininë, raportet për buxhetimin gjinor, çështjet e diskriminimit të grave dhe burrave, si edhe trajtimin e barabartë në të gjitha fushat e politikave.

Në Gjeorgji, Këshilli i Barazisë Gjinore është ngritur për të kryer analizën e legjislacionit ekzistues dhe të projekt-akteve për të eliminuar pabarazitë gjinore, për të hartuar dhe planifikuar aktivitete që promovojnë barazinë gjinore, për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e barabarta të burrave dhe grave, si edhe për të ngritur dhe zbatuar një sistem monitorimi dhe vlerësimi për matjen e ndikimit gjinor të akteve ligjore.

Në Moldavi, Komisioni i Grave ka kërkuar ekspertizë për masat e posaçme të përkohshme, nga Platforma e Barazisë Gjinore e përbërë nga 19 OJQ të njohura në Moldavi.

Në Monako, Komisioni kërkon rregullisht opinionin e OJQ-ve që merret me çështjet e grave dhe këto grupe mund t'i kërkojnë Komisionit të përfshijë çështje të caktuara në agjendën e vet.

Në Bjellorusi, Këshilli Kombëtar i Politikave është agjenci ndërinstitucionale dhe organ bashkërendues i përbërë nga titullarët e agjencive shtetërore qendrore, autoriteteve vendore ekzekutive dhe administrative dhe organizatave joqeveritare. Këshilli shërben si pikë fokale parlamentare për të gjitha çështjet që lidhen me barazinë gjinore dhe është përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazinë Gjinore, si dhe shërben si platformë për dialogun për problematikat e barazisë gjinore.

Në Bosnjë-Hercegovinë, Qipro dhe Rumani, burrat kanë kryesuar komisionet e barazisë gjinore, duke dërguar sinjalin publik se barazia gjinore u përket edhe burrave. Në disa vende, si Kroacia, anëtarësimi në komisionin e barazisë gjinore nuk është i kufizuar vetëm për deputetët, por përfshin edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe akademikë.

duhet të ndërmerret qeveria për një sërë çështjesh gjinore;

- **Hetimin e ankesave** për çështjet që lidhen me barazinë gjinore dhe rekomandimin e sanksioneve sipas rastit; dhe
- **Shqyrtimin e buxheteve dhe shpenzimeve publike nga perspektiva gjinore dhe kryerjen e auditimeve gjinore.**

Bazuar në përvojën ndërkombëtare, faktorët që kontribuojnë në efikasitetin e komisioneve të barazisë gjinore janë:

- **Qëndrueshmëria** – Komisionet e përhershme janë më efektive se sa ato ad hoc, sepse kanë funksione të përcaktuara qartë dhe zotërojnë burime të dedikuara për promovimin e barazisë gjinore;
- **Fuqia vendimmarrëse** – Komisionet me funksion thjesht këshillues kanë ndikim të kufizuar në garantimin e një analize gjinore të mirëfilltë të legjislacionit dhe në integrimin e aktiviteteve gjinore në ligje apo programe;
- **Fokus të qartë dhe plane veprimi** – Komisionet që punojnë sipas planeve të veprimit specifike për promovimin e barazisë gjinore janë më të efektshme në arritjen e objektivave;
- **Mbështetja e lidërshpimit parlamentar apo qeveritar** – Ky aspekt e lehtëson ndjeshëm punën e komisionit; si dhe

- **Anëtarësi e larmishme** – Nëse burrat kanë rol në drejtimin e këtyre komisioneve, kjo përcjell mesazhin e fortë se barazia gjinore është çështje edhe e burrave.

Kutia 6. Shembuj të funksioneve të komisioneve të barazisë gjinore

Komisioni për Barazi Gjinore i Republikës së Kroacisë është një nga 30 komisionet që monitorojnë zbatimin dhe promovimin e parimeve të barazisë gjinore në legjislacionin kroat. Komisioni gjithashtu: promovon nënshkrimin e dokumenteve ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe monitoron zbatimin e tyre; merr pjesë në hartimin, zbatimin dhe analizën e zbatimit të Politikës Kombëtare të Barazisë Gjinore; propozon paketa masash për të eliminuar diskriminimin gjinor; promovon përfaqësimin e balancuar gjinor në organet parlamentare dhe delegacionet; përgatit projekt-akte dhe rregullore për barazinë gjinore; dhe ndërmerr përpjekje për të futur parimet e barazisë gjinore në arsim, kujdes shëndetësor, informim publik, politikat sociale, punësim, sipërmarrjen e lirë, proceset e vendimmarrjes, marrëdhëniet familjare, etj.

Burimi: Dr. Sonia Palmieri, *Gender Sensitive Parliaments: A Global Review of Good Practice* (Geneva: Inter-Parliamentary Union, 2011) <<http://www.ipu.org/pdf/publications/gsp11-e.pdf>>.

Një nga komisionet e Parlamentit Evropian është përgjegjës për përcaktimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave brenda Bashkimit Evropian; promovimin e të drejtave të grave në vende të tjera; politikat e mundësive të barabarta, duke përfshirë barazinë ndërmjet burrave dhe grave në lidhje me mundësitë në tregun e punës dhe trajtimin në punë; eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit me bazë gjinore; zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të integritetit gjinor në të gjithë sektorët e politikave; ndjekjen dhe zbatimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e grave; dhe politikën e informimit për gratë.

Burimi: European Parliament Committees: FEMM Women's Rights and Gender Equality, <<http://www.europarl.europa.eu/committees/en/femm/home.html>>.

ii. Komisionet shumëportofolëshe që përfshijnë barazinë gjinore

Komisionet shumëportofolëshe që përfshijnë barazinë gjinore si një nga fushat e tyre të kompetencës dhe interesit ekzistojnë në shumicën e parlamenteve. Interesat sektoriale si shëndetësia, çështjet sociale, familja ose fëmijët, puna, arsimi dhe mirëqenia zakonisht kombinohen me çështjet e barazisë gjinore apo të grave.

Komisionet shumëportofolëshe që merren me barazinë gjinore ndahen në dy nëngrupe kryesore: ato me fokus të theksuar në **çështjet sociale dhe familjen** (p.sh. Komisioni për Politikat Familjare dhe Sociale i Senatit polak, Komisioni i Përhershëm i Parlamentit norvegjez për Çështjet Familjare dhe Kulturore) dhe ato që janë **të fokusuar te të drejtat e njeriut dhe çështjet**

ligjore dhe kushtetuese (p.sh. Komisioni Kushtetues i Parlamentit estonez, Komisioni i Përbashkët për Drejtësinë, Mbrojtjen dhe Barazinë i Dhomës së Ulët të Parlamentit irlandez).

Përvoja ndërkombëtare sugjeron se komisionet shumëportofolëshe mund të kenë aspekte pozitive dhe negative.

- Një avantazh i komisionit shumëportofolësh është se anëtarët e tij mund të aplikojnë metodat e integritimit të perspektivës gjinore në një rang më të gjerë çështjesh. Për më tepër, në teori, ekziston potenciali që anëtarët të aplikojnë strategji për integrimin e perspektivës gjinore në punën e komisioneve të tjera ku janë anëtarë.

Kutia 7. Parlamenti suedez

Të gjitha komisionet parlamentare të Parlamentit suedez janë përgjegjës për trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore në fushat përkatëse të punës. Gjithashtu, Akti Riksdag i vitit 2014 e ngarkon Komisionin për Tregun e Punës me përgjegjësinë e posaçme që të mbikëqyrë problematikën e barazisë gjinore mes burrave dhe grave në punë. Është zhvilluar një praktikë ku çështjet e barazisë gjinore që nuk u përkasin fushës së veprimit të komisioneve të tjera, i referohen

këtij komisioni, i cili bën edhe buxhetin nën programin "Integrimi dhe barazia gjinore".

Burimi: Marian Sawyer, Lenita Freidenvall, Sonia Palmieri, Playing their part? Parliamentary institutions and gender mainstreaming, Paper for Third European Conference on Politics and Gender, Universitat Pompeu Fabra, Barcelona, March 2013, <https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2488867>.

- Një disavantazh i komisioneve shumëportofolëshe është se nga anëtarët pritet që të adresojnë çështjet e barazisë gjinore si paketë midis një sërë paketash të tjera. Në praktikë, do të thotë që i kushtohet më pak kohë shqetësimeve specifike gjinore apo një analize gjithëpërfshirëse me bazë gjinore.

iii. Strukturat parlamentare të grave dhe rrjetet joformale

Një lloj i veçantë i strukturave parlamentare me fokus gjinor është edhe grupi parlamentar i grave deputete¹⁸. Në këto struktura marrin pjesë gra nga parti të ndryshme, përtej dasive partiake, që mund të përfshijnë edhe partnerë të tjerë si organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat.

Grupet e grave deputete janë krijuar për t'i shërbyer disa qëllimeve dhe funksioneve:

- Të promovojnë ndryshime ligjore për forcimin e barazisë gjinore, të identifikojnë çështje politikash që kërkojnë shqyrtim më të thelluar, të mbledhin të dhëna dhe të kryejnë hulumtime me qëllim forcimin e punës advokuese të grupit.
- Të mbështetin anëtarët e grupit përmes këshillimit, trajnimit, forcimit të kapaciteteve, ndërtimit e besimit, formimit e rrjeteve, diskutimet dhe shkëmbimin e informacionit.
- Të lehtësojnë komunikimin dhe dialogun brenda dhe përmes partive për një sërë çështjesh. Progres është bërë në lidhje me mbështetjen ndërpartiake, sidomos për çështje si dhuna ndaj grave, mosdiskriminimin, kujdesin shëndetësor dhe të drejtat e fëmijëve.

Organet parlamentare me fokus gjinor duhet edhe të ndërtojnë marrëdhënie me “agjentët e pushtetit” në Parlament (përfshi këtu ekzekutivin dhe opozitën), si edhe me komisionet parlamentare përkatëse

Klubi Parlamentar i Grave në Kuvendin e Republikën e Maqedonisë së Veriut advokoi me sukses për miratimin e një ndryshimi në Kodin Zgjedhor që garanton se çdo vend i tretë në listën e kandidatëve të partive t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar.

Në Estoni dhe Poloni, grupet e grave ndihmuan në miratimin e legjislacionit kundër dhunës në familje.

Rrjeti i Grave Deputete në Parlamentin finlandez organizon seminare dhe aktivitete jozyrtare që nxisin shkëmbimin e informacionit dhe ndërgjegjësimin për çështjet gjinore.

Në Maqedoninë e Veriut, Klubi i Grave Parlamentare ka vendosur marrëdhënie të ngushta me Komisionin për Shanse të Barabarta për Burrat dhe Gratë. Kryetari i këtij komisioni është gjithashtu pjesëtar i lidërshit të klubit, dhe kryetarja e klubit ftohet zyrtarisht të marrë pjesë në të gjithë takimet e Komisionit. Kjo marrëdhënie e ngushtë ka sjellë një bashkëpunim strategjik mes këtyre dy organizmave.

Në Serbi, Rrjeti i Grave Parlamentare bashkëpunon ngushtë me Komisionin Parlamentar për Të Drejtat e Njeriut dhe të Minoriteteve.

18 Një studim i realizuar nga ODIHR në 2003 konstatoi se strukturat e grave parlamentare ekzistonin si grupe ndërpartiake në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kanada, Kirgizistan, Maqedoninë e Veriut, Moldavi, Poloni, Republikën Sllovaqe dhe SHBA. Ato ekzistojnë edhe në Kosovë. Grupet e grave brenda partive ekzistojnë në Austri, Kanada dhe Norvegji. Shoqatat vullnetare, klubet apo rrjetet luajnë këtë rol në Andora, Danimarkë, Finlandë, Kazakistan, Norvegji, Serbi, Suedi, Tashikistan dhe Ukrainë. Grupet e fokusuar në çështje gjinore ekzistojnë në Kanada, Estoni dhe SHBA, ndërsa në Gjeorgji ekziston si platformë që përfshin shoqërinë civile dhe të tjerë.

Në Finlandë, Njësia e Barazisë, e cila nga ana administrative është e lidhur me Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe Shëndetit në Finlandë, organizon rregullisht seminare dhe trajnime, të cilat janë të hapura për të gjitha ministrat. Këto aktivitete i ndihmojnë pjesëmarrësit të integrojnë perspektivën gjinore në punën e tyre. Gjithashtu, Njësia e Barazisë koordinon politikën gjinore të qeverisë, si dhe punon për masa të tjera që lidhen me çështjet gjinore.

Bundestagu gjerman ka vendosur lidhje zyrtare me njësinë e dedikuar për barazinë gjinore në **Universitetin Humboldt në Berlin**, duke siguruar akses në analiza gjinore cilësore për deputetët dhe personelin.

Parlamenti austriak, i cili nuk ka një grup ndërpartiak të grave deputete apo një komision të posaçëm për barazinë gjinore, u ofron deputetëve –me kërkesë - një larmi të madhe shërbimesh kërkimore me ndjeshmëri gjinore nga **Biblioteka e Parlamentit**. Biblioteka mbledh dhe përpilon të dhëna sipas gjinisë për një gamë të gjerë treguesish, përfshirë përfaqësimin e grave në Parlament; formimin dhe përvojën e mëparshme të tyre; si edhe përkatësinë partiake. Disa të dhëna janë publike dhe disa përgatiten për përdorim nga Deputetët dhe Senatorët.

që trajtojnë çështjet gjinore në punën e tyre. Këto marrëdhënie janë të rëndësishme, sepse organet parlamentare të grave rrallë gëzojnë fuqinë për të bërë ndryshimet që kërkojnë. Prandaj, ndërtimi i marrëdhënieve me komisionet apo organet parlamentare është i rëndësishëm për zbatimin e strategjive për integrimin e perspektivës së barazisë gjinore.

iv. Njësitë teknike gjinore dhe shërbime kërkimore të jashtme

Organet parlamentare me fokus gjinor mund të marrin edhe trajtën e “njësive teknike” apo shërbimeve kërkimore.

Shërbimet kërkimore luajnë rol të rëndësishëm në sigurimin e informacionit dhe kërkimit mbi ndikimin gjinor të legjislacionit, si dhe forcon njohuritë dhe kapacitetet e deputetëve në lidhje me çështjet gjinore. Komisionet parlamentare, grupet e grave deputete dhe shërbimet kërkimore shpesh **bazohet te asistenca dhe mbështetja e grupeve të grave jashtë parlamentit**. Shpesh ato organizojnë tryeza të rrumbullakëta me organizatat e grave dhe institucionet kërkimore, për të evidentuar problematikat gjinore në lidhje me një legjislacion të caktuar. Organizatat joqeveritare dhe *think tank-et* që punojnë në fushën e barazisë gjinore mund të **ofrojnë kërkime dhe statistika** që ndihmojnë grupin e grave deputete të formulojë propozime legjislative ose të përgatitet për diskutime legjislative. Kështu, marrëdhëniet ndërmjet organizatave, grupeve dhe qendrave joparlamentare të grave dhe organeve parlamentare të grave mund të shërbejnë si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e njohurive dhe forcimin e kapaciteteve.

(c) Faktorët favorizues për prezantimin e LNGj-së

Kushtet dhe faktorët favorizues që kontribuojnë dhe lehtësojnë institucionalizimin e LNGj-së nëpërmjet miratimit të strategjive LNGj dhe krijimit të organeve parlamentare të posaçme përfshijnë:

- **Mbështetja e partisë në pushtet dhe drejtuesve parlamentarë** – Një anketë e kryer nga Unioni Ndërparlamentar (IPU) në 2011-ën synonte të vlerësonte faktorët për integrimin dhe institucionalizimin e LNGj-së. Të anketuarit treguan se faktori kryesor është shkalla e mbështetjes që jep partia në pushtet, e ndjekur nga shkalla e mbështetjes nga drejtuesit e Parlamentit (p.sh. Kryetari).¹⁹
- **Mbështetja nga gratë deputete** – Anketa e IPU-së tregoi se shkalla e mbështetjes për integrimin e perspektivës gjinore nga gratë deputete është më e rëndësishme se sa numri i grave në Parlament;²⁰
- **Bashkëpunimi ndërpartiak dhe disiplina partiake** – Një studim i ODIHR-it i kryer në vitin 2003 tregoi se organet parlamentare me fokus gjinor ishin krijuar në sisteme të ndryshme parlamentare dhe presidenciale, si dhe në parlamente të zgjedhur me të gjitha llojet e sistemeve zgjedhore (d.m.th. proporcional, miks dhe mazhoritar). Për këtë arsye, të vetëm këta faktorë nuk mjaftojnë për të përcaktuar nëse një organ është ngritur apo jo, apo se sa i efektshëm është. Nga ana tjetër, shkalla e bashkëpunimit apo polarizimit ndërpartiak dhe disiplina e partive politike mund të ketë ndikim të ndjeshëm në ngritjen e strukturave parlamentare të grave, si edhe në formën që marrin ato. Për shembull, **parlamentet bashkëpunuese arrijnë të krijojnë grupe ndërpartiake**, ndërsa parlamentet e përbëra nga **parti me disiplinë të lartë kanë më shumë nevojë për një komision të strukturuar**, ku rregullat janë të qarta dhe gjykohen nga personeli parlamentar. Gjithashtu, një rrjet joformal ka më shumë gjasa të ngrihet në mjedise me debate të ashpra politike;²¹
- **Momenti i duhur** – Anketa e IPU-së nënvizoi rëndësinë e momentit të duhur në promovimin e perspektivës së integritimit të LNGj-së. Një qasje është miratimi i një strategjie LNGj brenda **një reforme të gjerë socio-**

19 Parlamentet me Ndjeshmëri Gjinore: Shqyrtim Global i Praktikave të Mira (Gjenvë: Unioni Ndërparlamentar, 2011) <<http://www.ipu.org/pdf/publications/gsp11-e.pdf>>.

20 Po aty.

21 Studim Krahasues i Strukturave për Gratë Deputete në Rajonin e OSBE-së (Varshavë: ODIHR, 2013), <<http://www.osce.org/odihr/105940>>.

ekonomike. Një tjetër qasje është miratimi i LNGj-së si përgjigje ndaj një **krize politike** apo polemike në qeveri; si dhe

- **Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile me fokus gjinor**
– Mekanizmat parlamentarë të integrimit gjinor kanë pak gjasa të jenë të suksesshëm nëse nuk mbështeten nga organizata të shoqërisë civile. Këto organizata janë të rëndësishme qoftë për të ofruar informacion për komisionet parlamentare, si edhe për të kërkuar llogari nga parlamentarët.

Për çudi, faktorët që të anketuarit e IPU-së konsideronin më pak të rëndësishëm për integrimin e LNGj-së përfshijnë mbështetjen nga komuniteti i biznesit dhe nga zonat elektorale.

Pjesa V. Përfundime

Parlamentet janë në pozita solide për të ofruar modele të mira për integrimin e perspektivës gjinore përmes procesit ligjvënës, të cilat mund të shërbejnë si shembull për për agjencitë qeveritare dhe organizatat e tjera. Integrimi i perspektivës gjinore në legjislacion mundëson që shqetësimet, nevojat dhe përvojat e grave dhe burrave të merren plotësisht parasysh gjatë hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të ligjeve.

Ky udhëzues thekson se integrimi i suksesshëm i legjislacionit me ndjeshmëri gjinore duhet të mbështetet në përmbushjen e disa parakushteve:

- 1** Së pari, zbatimi i LNGj-së kërkon **të kuptohet plotësisht se çfarë është LNGj**. LNGj është integrimi i aktiviteteve dhe perspektivave të barazisë gjinore. LNGj nuk e sheh gjininë si një çështje të izoluar, por kërkon të integrojë qartë dimensionin gjinor në të gjitha programet dhe aktivitetet e parashikuara nga ligji. LNGj nuk lidhet ekskluzivisht vetëm me gratë, por me marrëdhënien midis grave dhe burrave për të mirën e ndërsjellë. Ai nuk ka të bëjë domosdoshmërisht me “neutralitet gjinor”, por më tepër me ndjeshmërinë ndaj gjinisë, duke synuar zbutjen dhe korrigjimin e pabarazive ekzistuese. LNGj nuk është një model ideal që u përshtatet të gjitha grave dhe burrave, por një analizë e thelluar e kushteve specifike, nevojave dhe prioriteteve të grupeve të ndryshme në shoqëri.
- 2** Së dyti, **analiza gjithëpërfshirëse me bazë gjinore** është komponent thelbësor i LNGj-së. Kjo analizë bazohet në mbledhjen e të dhënave të plota nga të gjitha burimet e disponueshme dhe angazhimin e palëve të interesuara në kuptimin dhe përcaktimin e nevojave dhe prioriteteve praktike dhe strategjike të burrave dhe grave në një sektor të caktuar. Si pjesë e vlerësimit të ndikimit konkret të një akti legjislativ, ky vlerësim gjithashtu kërkon një identifikim të qartë të grupeve të synuara dhe një analizë të bazuar në fakte që tregon mënyrën në të cilën secili prej këtyre grupeve ndikohet nga

ligji në fjalë. Analiza gjinore kërkon identifikimin e aktiviteteve që mund të integrohen në mënyrë të arsyeshme në ligj, pa e mbingarkuar artificialisht atë, përmes zgjerimit të shtrirjes dhe ndikimit të tij. Së fundi, analiza me bazë gjinore kërkon krijimin e një kuadri monitorimi dhe vlerësimi që përmban tregues me ndjeshmëri gjinore që të maten gjatë zbatimit të ligjit për të vlerësuar ndikimin në grupe të ndryshme përfituese.

3 Së treti, LNGj nuk mund të jetë i suksesshëm në mungesë të **kuadrit institucional**. Një mjedis i favorshëm institucional përbëhet nga një strategji veprimi LNGj që është pjesë e një kuadri legjislativ zyrtar dhe me përshkrime të qarta të roleve, funksioneve dhe përgjegjësive institucionale dhe të rezultateve që duhet të arrijnë aktorë të ndryshëm të angazhuar në zbatimin e LNGj-së. Gjithashtu, zbatimi efikas i LNGj-së kërkon infrastrukturë parlamentare, siç janë komisionet e barazisë gjinore, komisionet shumë-portofolëshe që përfshijnë barazinë gjinore, grupet e grave deputete apo rrjetet joformale, si dhe mundësi forcimi kapacitetesh dhe trajnimesh të ofruara nga shërbimet kërkimore parlamentare. Procesi përfshirës i LNGj-së kërkon edhe bashkëpunim mes palëve të interesuara të jashtme dhe të brendshme që jo vetëm kontribuojnë, por edhe përfitojnë nga angazhimi me çështjet gjinore.

Shtojca I. LNGj në Bjellorusi: Rast Studimor

(a) Panorama e barazisë gjinore në Bjellorusi

Bjellorusia ka nënshkruar dhe ka ratifikuar një sërë dokumentesh ndërkombëtare që synojnë promovimin e barazisë gjinore, duke përfshirë CEDAW (1979), Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim të Konferencës së Katërt Botërore (1995), Protokollin fakultativ të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (2004), dhe neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Bjellorusisë parashikon se parimet e njohura ndërkombëtarisht të së drejtës ndërkombëtare prevalojnë mbi legjislacionin e brendshëm dhe ky i fundit duhet të jetë në pajtim me këto parime.

Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Bjellorusisë deklaron se të gjithë qytetarët “janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa diskriminim për mbrojtje të barabartë të të drejtave dhe interesave të tyre legjitime”. Edhe parimet formale të barazisë dhe mosdiskriminimit para ligjit në marrëdhëniet familjare, arsimore, profesionale, sociale, politike, kulturore dhe në sferat e tjera janë të mishëruara në Kushtetutë (nenet 32, 42), në Kodin e Familjes dhe të Martesës (neni 20), në Kodin Penal dhe Kodin Civil, në Kodin e Punës dhe në Ligjin për Procedurën dhe Kushtet e Ndalimit. Këto ligje në fushat e tyre përkatëse ndalojnë diskriminimin mbi bazë gjinie apo për arsye të tjera.

Bjellorusia renditet lart në indekset ndërkombëtare që matin zhvillimin njerëzor dhe respektimin e parimeve të barazisë gjinore. Raporti Global i Zhvillimit Njerëzor i UNDP 2015 vendos Bjellorusinë në nivelin e parë, mes vendeve me performancë të lartë në zhvillimin njerëzor, ku Bjellorusia zë vendin e 50-të nga 188 vende.²² Raporti i vitit 2015 gjithashtu rendit Bjellorusinë midis

22 “Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2015, UNDP, 2015, <http://hdr.undp.org/sites/default/files/2015_human_development_report_1.pdf>.

vendeve ku Indeksi i Zhvillimit Gjinor të Grave është i barabartë ose më i lartë sesa i burrave (1.021).²³ Për hir të krahasimit, në Raportin Global të Zhvillimit Njerëzor 2014, Bjellorusia mbante vendin e 53-të (nga 188) në Indeks të Zhvillimit Gjinor.²⁴ Sipas Raportit Global të Hendekut Gjinor 2016 nga Forumi Ekonomik Botëror, Bjellorusia renditet e 30-ta nga 144 shtete.²⁵ Për më tepër, Bjellorusia është midis 16 vendeve në kategorinë me “diskriminim shumë të ulët” në institucionet sociale dhe indeks gjinor, të llogaritur nga Qendra për Zhvillimi e OECD-së bazuar në 14 tregues në vitin 2014.²⁶

Planet kombëtare të veprimit për të arritur barazinë gjinore shërbejnë si instrumenti kryesor ligjor për të promovuar legjislacionin dhe politikën me ndjeshmëri gjinore në Bjellorusi. Plani Kombëtar i Veprimit i katërti dhe i fundit për barazinë gjinore të Republikës së Bjellorusisë për vitet 2011-2015 u miratua nga Këshilli i Ministrave në gusht 2011.²⁷ Plani deklaronte se zbatimi i politikës gjinore në Bjellorusi bazohet në normat e njohura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore dhe synon: të promovojë përfaqësimin e barabartë të burrave dhe grave në të gjitha nivelet e qeverisjes; të integrojë gjininë në sistemin arsimor; të ndërgjegjësojë publikun për çështjet e barazisë gjinore në të gjitha sferat e jetës publike; të përmirësojë shëndetin riprodhues të burrave, grave dhe adoleshentëve për të siguruar riprodhimin normal të popullsisë; dhe të përmirësojë cilësinë e jetës. Vëmendje e veçantë i kushtohet forcimit të institucionit të familjes dhe marrëdhënieve familjare, duke advokuar martesën dhe vlerat e familjes, arritjen e barazisë gjinore në familje, përfshirë angazhimin e meshkujve në familje dhe në kujdesin e fëmijëve. Plani gjithashtu thekson rëndësinë e inkurajimit të sipërmarrjes së grave dhe rritjen e konkurrueshmërisë së grave në tregun e punës, si dhe transformimin e vetëdijes publike në lidhje me barazinë gjinore dhe çrrënjosjen e stereotipave gjinore diskriminues. Plani i pestë kombëtar, për periudhën 2017-2020, është përgatitur dhe aktualisht është në shqyrtim në qeveri .

23 Indeksi i Zhvillimit Gjinor (GDI) mat hendekët gjinore në arritjet e zhvillimit njerëzor, duke matur mungesën e paritetit ndërmjet grave dhe burrave në tre dimensione bazë të zhvillimit njerëzor: shëndeti, njohuritë dhe standardi i jetesës. GDI është raporti mes indekseve të zhvillimit njerëzor të llogaritur veçmas për femrat dhe meshkujt duke përdorur të njëjtën metodologji. Ai është matje e drejtpërdrejtë e hendekut gjinor dhe tregon sa mbrapa po mbeten gratë krahasuar me homologët e tyre meshkuj dhe se si gratë duhet të mbushin këtë hendek brenda secilit dimension të zhvillimit njerëzor. Për më shumë hollësi për GDI, shih: < <http://hdr.undp.org/en/content/gender-development-index-gdi>>.

24 “Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2014”, UNDP, 2014, <http://hdr.undp.org/sites/default/files/hdr14-report-en-1.pdf>.

25 “Raporti Global i Hendekut Gjinor 2016: Bjellorusi”, Forumi Ekonomik Botëror, <<http://reports.weforum.org/global-gender-gap-report-2016/economies/#economy=BLR>>.

26 “Institucionet Sociale dhe Indeksi Gjinor: Raport Sintezë 2014”, OECD, <<https://www.oecd.org/dev/development-gender/BrochureSIGI2015-web.pdf>>.

27 I pari Plan Veprimi mbulonte periudhën 1996-2000; i dyti mbulonte periudhën 2001-2005 dhe i treti periudhën 2008-2010.

Sfidat e barazisë gjinore në Bjellorusi lidhen me integrimin e grave në tregun e punës dhe stereotipat gjinorë. Në vitin 2015, 56.1% e grave bjelloruse dhe 43.9% e meshkujve bjelloruse kishin arsim të lartë. Sipas censusit të vitit 2009, 57.4% e grave dhe 42/6% e burrave kanë arritur nivelin e arsimit të lartë. Megjithatë, gratë shpesh nuk kanë pozicione drejtuese dhe punojnë kryesisht në sektorin publik dhe në sektorë si shëndetësia dhe arsimit.²⁸ Komentuesit e shoqërisë civile gjithashtu i referohen “feminizimit” të sferave të nënpaguara të aktivitetit ekonomik, përjashtimit të grave nga nivelet drejtuese, hendekut të ndjeshëm të pagave ndërmjet burrave dhe grave (një shpjegim për këtë mund të jetë prirja më e lartë e grave për të pranuar punë me pagë më të ulët) dhe mungesa e politikave të barabarta për lejen prindërore.²⁹ Sfidat shtesë përfshijnë aksesin në kujdesin shëndetësor (dhe në veçanti shëndetin riprodhues), mbajtjen e stereotipave gjinorë dhe qëndrimeve atërore ndaj grave, si dhe dhunën në familje.

Sfidë është edhe pjesëmarrja e grave në jetën politike dhe publike. Edhe pse gati 1/3 e deputetëve në Bjellorusi janë gra, komentuesit e shoqërisë civile theksojnë se gratë janë të nënpërfaqësuar në postet më të larta në qeveri, gjyqësor dhe në shërbimin diplomatik.³⁰ Shpesh ato përjashtohen nga rrjetet politike të burrave; në përgjithësi konceptet e barazisë gjinore mungojnë në programet zgjedhore si të kandidatëve meshkuj ashtu edhe të femrave. Së bashku me barrierat ekonomike që pengojnë gratë të marrin pjesë në jetën politike dhe publike të vendit, shpesh thuhet se politikanet dhe sipërmarrëset janë të pa favorizuara, për shkak të qëndrimeve paragjyquese ndaj tyre.

Raporti i vitit 2016 për Bjellorusinë nga Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Gjinor ndaj Grave rekomandon krijimin e një mekanizmi të centralizuar kombëtar për avancimin e grave, me mandat dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë. Raportoi theksonte se ky mekanizëm duhet të mbështetet me burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknike, që të mund të bashkërendojë dhe të promovojë në mënyrë efektive barazinë gjinore dhe integrimin gjinor. Komiteti gjithashtu rekomandoi që Departamenti për Popullsinë dhe Politikën Gjinore dhe Familjare i Ministrisë së Punës dhe Mbrojtjes Sociale të fokusohet më shumë në barazinë gjinore dhe

28 “Raport Alternativ për Përpunshmërinë me Konventën për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave nga Bjellorusia”, përgatitur nga Qendra Anti-diskriminim me asistencën e Qendrës “Her Rights” për sesionin e 65-të të CEDAW, 2016, <<https://adcmemorial.org/wp-content/uploads/BelENGwww.pdf>>.

29 Dzmity Ananyeu et al., “Raport Kombëtar për Pjesëmarrjen e Grave në Jetën Publike dhe Politike, Bjellorusi, 2013, <https://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:udzuoNYCcXsJ:https://rm.coe.int/1680599095+&cd=1&hl=en&ct=clnk&gl=pl>” and S. Burova & O. Yanchuk, “Analizë e Sektorit Gjinor në Bjellorusi”, Zyra për Ekspertizë Evropiane dhe Komunikime, 2014, <<http://eng.oecb.by/wp-content/uploads/2015/06/Analysis-of-Gender-Sector-in-Belarus.pdf>>.

30 Po aty.

çështjet e të drejtave të grave dhe bëri thirrje për miratimin sa më të shpejtë të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020 dhe alokimin e burimeve adekuate njerëzore, teknike dhe financiare për zbatimin e tij.

(b) Analiza LNGj në Bjellorusi: palët e interesuara dhe pikënisjet

Që nga vera e vitit 2017, në Bjellorusi nuk është zbatuar zyrtarisht një analizë sistematike e ndjeshmërisë gjinore të legjislacionit. Pjesa më e madhe e akteve legjislative në Bjellorusi kanë neutralitet gjinor dhe çështjet gjinore mungojnë gjerësisht në agjendat politike dhe legjislative. Analiza e rregullt e ndikimit gjinor të projektligjeve nuk është detyrim ligjor. Megjithatë, mund të merren në konsideratë disa pika hyrëse për integrimin e një analize të tillë.

Aktori kryesor qeveritar në fushën e barazisë gjinore në Bjellorusi është Këshilli Kombëtar për Politikën Gjinore nën Këshillin e Ministrave (Këshilli Kombëtar). Këshilli u krijua në vitin 2000 si organ këshillues dhe bashkërendues ndërinstytucional i përbërë nga drejtues të agjencive të qeverisë qendrore, autoriteteve vendore ekzekutive dhe administrative, deputetë të Asamblesë Kombëtare dhe përfaqësues të Gjykatës së Lartë, organizatat publike dhe ndërkombëtare (gjithsej 31 individë, 21 gra dhe 10 burra). Këshilli është përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve sipas Planit Kombëtar të Veprimit dhe synon të shërbejë si platformë dialogu për të diskutuar mbi progresin e bërë në adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, si edhe për të ofruar këshilla dhe rekomandime mbi barazinë gjinore tek qeveria. Megjithatë, organizatat vendore të shoqërisë civile theksojnë se Këshilli nuk ka buxhet, burime dhe autoritet të mjaftueshëm. Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Gjinor ndaj Grave (CEDAW) nënvizon në raportin e 2016-ës për Bjellorusinë se Këshilli mblidhet dy herë në vit dhe “nuk arrin të funksionojë si mekanizëm kombëtar efektiv për avancimin e grave.”³¹

- **Pikënisja për analizën LNGj** - Këshilli Kombëtar përfiton nga shumëllojshmëria e anëtarëve të saj; ai përbëhet nga deputetë, kryetarë dhe anëtarë të komisioneve parlamentare, përfaqësues të agjencive qeveritare dhe organizatave të shoqërisë civile. Pavarësisht kufizimeve financiare dhe strukturore, Këshilli mund të shërbejë si një platformë efektive për bashkërendimin dhe shkëmbimin e njohurive midis anëtarëve të vet, të cilët mund të luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të barazisë gjinore në Parlament dhe në të gjitha agjencitë qeveritare.

31 “Përfundimet e raportit të tetë periodik për Bjellorusinë”, Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, nëntor 2016, <http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2fC%2fBLR%2fCO%2f8&Lang=en>.

Agjencia qeveritare që ka tagrin për të trajtuar çështjet gjinore është **Departamenti i Popullsisë dhe Politikave Gjinore e Familjare në Ministrinë e Punës dhe Mbrojtjes Sociale**. Departamenti inicion rregullisht politika dhe programe gjinore, paraqet komente për projektligjet dhe jep rekomandime me bazë gjinore që duhet të merren parasysh nga agjencitë e tjera. Megjithatë, kjo ndodh zakonisht në baza ad hoc, në varësi të objektit dhe specifikave të ligjeve të reja, por nuk ka pasur asnjë përpjekje sistematike për të përfshirë analizën e ndikimit gjinor të legjislacionit në punën e departamentit. Për më tepër, Komiteti CEDAW vuri në dukje në raportin e vitit 2016 se kapacitetet e këtij departamenti për të çuar përpara barazinë gjinore janë të kufizuara, për shkak se si fokus primar ka “çështjet familjare dhe demografike, dhunën ndaj grave dhe trafikimin.”³²

- **Pikënisja për analizën LNGj** – Duke pasur parasysh përvojën e gjerë të departamentit në trajtimin e çështjeve gjinore dhe njohjen e thellë të situatës gjinore në vend, mund të kryejë një funksion të rëndësishëm: të japë kontribut sistematik për ndikimet gjinore të propozimeve ligjore që janë relevante për sferën e veprimtimit të Ministrisë. Këto kontribute mund të përcillen te ministrinë përkatëse të linjës, ose të bashkërendohen me **Qendrën Kombëtare të Legjislacionit dhe Kërkimeve Ligjore (QKLKL)**, funksionet e të cilës janë përshkruar më poshtë.

QKLKL është një aktor premtues që mund të udhëheqë integrimin e analizës LNGj në aktet legjislative. Themeluar me dekret presidencial në vitin 2007, QKLKL ka 53 punonjës. Kjo qendër ka për detyrë të hartojë “draftet e akteve normative ligjore, udhëzimet metodike të veprimtarisë rregulluese, të kryejë studime kërkimore në fushën e së drejtës, si dhe të trajtojë shkencëtarë me nivel të lartë aftësish”.³³ Të gjitha agjencitë qeveritare që janë të interesuara për aktet e reja legjislative duhet të dorëzojnë propozime në QKLKL, e cila harton projektligjet e reja sipas një plani vjetor. QKLKL gjithashtu siguron ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e deputetëve dhe përfaqësuesve të agjencive qeveritare në fusha të ndryshme ligjore.

- **Pikënisja për analizën LNGj** - QKLKL është pikënisje shumë premtuese për përfshirjen e analizës LNGj, për shkak të rolit të saj qendror në procesin ligjvënës në vend. QKLKL harton të gjithë projektligjet e reja dhe asnjë ligj nuk mund të miratohet pa kaluar së pari përmes këtij institucioni. Prandaj, mandati i QKLKL për të kryer në mënyrë sistematike analiza të ndikimit gjinor në të gjitha propozimet legjislative që harton dhe përfshirja e aktiviteteve dhe

32 Po aty.

33 Faqja e internetit e Qendrës Kombëtare e Legjislacionit dhe Kërkimit Ligjor (QKLKL): <<http://center.gov.by/legal-status/?lang=en>>.

treguesve gjinorë në këto propozime do të integronte me efektivitet LNGj-në në Bjellorusi. Gjithashtu, QKLLK mund të luajë rol qendror në ndërtimin e kapaciteteve të deputetëve dhe përfaqësuesve të agjencive qeveritare për çështjet gjinore. Në të vërtetë, disa nga këto aktivitete janë parashikuar në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazinë Gjinore për 2017-2020. QKLLK duhet të marrë financim shtesë për të kryer këtë funksion dhe duhet të ketë ngritje të kapaciteteve të personelit të QKLLK që të njohë plotësisht të gjitha nuancat e analizës LNGj në sektorë të ndryshëm. Ky investim për kapacitetet e QKLLK mund të garantojë që analiza LNGj të zbatohet tërësisht dhe të pozicionojë Bjellorusinë midis liderëve botërorë në përfshirjen e parimeve të barazisë gjinore në punën legjislative.

Edhe **Ministria e Drejtësisë** shqyrton të gjitha projekt-aktet dhe analizon nëse janë në përputhje me parimet kushtetuese si dhe konsistencën me akte të tjera legjislative. Meqenëse barazia gjinore është një parim kushtetues në Bjellorusi, Departamenti i Rregullimit Ligjor të Aktiviteteve Shoqërore Shtetërore shqyrton aspektet gjinore dhe rreziqet e mundshme gjinore të legjislacionit të ri. Por, Departamenti duket se ka më pak burime sesa QKLLK për të kryer analizë sistematike dhe të thelluar me bazë gjinore.

Një tjetër aktor premtues në fushën e LNGj-së në Bjellorusi është **Komisioni Kombëtar i Statistikave (KKS), i cili grumbullon të dhëna të ndara sipas gjinisë** mbi një sërë çështjesh. Një sipërmarrje e madhe e KKS është grumbullimi i të dhënave familjare. Gjithashtu, me mbështetjen e UNICEF-it në vitin 2012, KKS kreu një sondazh me indikatorë të shumëfishtë për të vlerësuar gjendjen e fëmijëve dhe grave në Bjellorusi. Sondazhi kishte për qëllim matjen e progresit në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe ndihmoi në marrjen e të dhënave unike për marrëdhëniet gjinore, përfshirë shëndetin riprodhues të grave, qëndrimet e grave dhe burrave ndaj dhunës në familje, ndërgjegjësimin e burrave për HIV/AIDS, etj. Një tjetër sondazh i KKS, i njohur si “Përdorimi i kohës”, u krye në vitet 2014-2015 dhe mblodhi të dhëna të rëndësishme që konfirmuan stereotipat gjinorë ekzistues në shoqëri në lidhje me shpërndarjen e roleve në familje, si dhe ndihmoi në krijimin e panoramës mbi dallimet me bazë gjinore në përdorimin e kohës.

Që në vitin 2000, KKS ka zhvilluar **një bazë të dhënash me statistika gjinore, e cila përfshin tregues me ndjeshmëri gjinore** në fusha tematike si: ekonomia, varfëria, arsimi, shëndetësia, demografia, fëmijët dhe adoleshentët, dhuna, autoritetet dhe vendimmarrja në shoqëri dhe familje, komunikimi dhe mjedisi. Sistemi bazohet në treguesit gjinorë që përdor Komisioni Ekonomik i

OKB-së për Evropën (UNECE), dhe merr në konsideratë veçoritë kombëtare dhe propozimet e bëra nga Këshilli Kombëtar Gjinor. KKS publikon buletine vjetore me statistika të përgjithshme gjinore në fusha të ndryshme, por këto të dhëna nuk janë të hapura për publikun.

- **Pikënisja për analizën LNGj** – Të dhënat e KKS-së mund të shërbejnë si burim qendror informacioni për analizën LNGj që kryejnë institucionet e tjera, si QKLL apo Ministria e Punës dhe Mbrojtjes Sociale.

Në Bjellorusi, ka rreth 32 OJQ që trajtojnë çështjet gjinore. OJQ-të dhe drejtuesit më aktivë janë: OJQ-ja ndërkombëtare “Perspektivat gjinore”, “Shoqata e krishterë e të rejave bjelloruse”, “Lëvizja e pavarur demokratike e grave”, “Radislava” dhe nisma feministe “Rruga gjinore”. Këto organizata monitorojnë vendimet dhe veprimet e qeverisë për çështje të ndryshme gjinore, por ndikimi i tyre në opinionin publik është i kufizuar. OJQ-të e të drejtave të njeriut në Bjellorusi nuk janë fort aktive në çështjet gjinore, ndërsa sindikatat në përgjithësi nuk angazhohen në promovimin e parimeve të barazisë gjinore.

- **Pikënisjet për analizën LNGj** – Siç ndodh shpesh në vendet e tjera, OJQ-të që merren me çështjet gjinore mund të angazhohen në diskutimet për ndikimin gjinor të projekt-akteve. Këto diskutime mund të bashkërendohen nga Këshilli Kombëtar dhe/ose QKLL.

(c) Mundësitë për veprim të mëtjshëm

Integrimi i perspektivës së barazisë gjinore dhe LNGj në Bjellorusi mund të bëhet duke përfutur plotësisht nga institucionet dhe kapacitetet e saj ekzistuese. Bjellorusia ka arritur renditje të lartë në indekset ndërkombëtare të zhvillimit njerëzor dhe barazisë gjinore. Ky kapacitet i lartë duhet të shfrytëzohet për të promovuar barazi gjinore thelbësore - dhe jo vetëm formale. Siç u tha më lart, Këshilli Kombëtar, QKLL dhe KKS mund të shërbejnë si shtylla institucionale për integrimin e barazisë gjinore dhe LNGj-së.

QKLL, nëse i jepet mandati dhe burimet e duhura, mund të udhëheqë integrimin e analizës gjinore për të gjitha projekt-aktet, të integrojë sistematikisht perspektivat dhe aktivitetet gjinore në të gjitha projektligjet që harton dhe të zhvillojë një kuadër koherent monitorimi dhe vlerësimi për matjen e ndikimeve gjinore të legjislacionit ekzistues. Ajo gjithashtu mund të marrë rolin udhëheqës në kryerjen e trajnimeve dhe aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve të deputetëve dhe përfaqësuesve të agjencive qeveritare në lidhje me barazinë gjinore. Duke pasur parasysh fushën e gjerë të veprimit të QKLL-

së për të hartuar të gjithë projektligjet në vend, ky institucion ofron një mundësi të rrallë për të promovuar LNGj-në përmes një institucion të vetëm, dhe kështu Bjellorusia të renditet mes udhëheqësve botërorë në LNGj.

Këshilli Kombëtar mund të luajë rol të rëndësishëm në integrimin e LNGj-së dhe promovimin e barazisë gjinore, duke shërbyer si **platformë bashkërendimi dhe shkëmbimi njohurish** për anëtarët e vet. Alokimi i burimeve financiare shtesë do ta ndihmonte Këshillin në kryerjen e funksioneve të tilla.

KKS aktualisht kryen funksion kyç në **mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit**. Këto të dhëna mund të jenë shumë informuese për analizën LNGj në sektorë të ndryshëm dhe duhet t'u shpërndahen të gjitha agjencive shtetërore dhe QKLKL-së. Është e rëndësishme që KKS të bashkërendojnë mbledhjen e të dhënave me aktivitetet LNGj të QKLKL-së (ose një tjetër institucion i ngarkuar me analizën LNGj).

Departamenti për Popullsinë dhe Politikat Gjinore dhe Familjare pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale mund të kontribuojë duke iu përcjellë njohuritë dhe ekspertizën e vet agjencive të tjera shtetërore, si edhe QKLKL-së, në mënyrë që të japin kontribute me bazë gjinore për projektet.

Bazuar në praktikat e mira ndërkombëtare, metoda më e mirë përbëhet nga kombinimi i qasjeve lart-poshtë dhe poshtë-lart. Në qasjen lart-poshtë, dy strategji mund të jenë të dobishme:

- Së pari, rëndësia dhe nevoja për integrimin e perspektivës së barazisë gjinore dhe LNGj-së në Bjellorusi duhet të përcillet në nivelin më të lartë politik. Identifikimi i zyrtarëve të lartë që mund të shërbejnë si 'avokatë gjinorë' mund të jetë thelbësor për promovimin e barazisë gjinore dhe avancimin e kauzës së integritimit LNGj; dhe
- Së dyti, është e rëndësishme të ekzistojë një akt ligjor i qartë që detyron QKLKL-në të kryejë analizë me bazë gjinore të të gjitha projekt-akteve.

Për qasjen nga poshtë-lart, mund të testohen dy strategji:

- Së pari, është e dobishme të forcohen kapacitetet dhe të rriten burimet e Këshillit Kombëtar për të krijuar marrëdhënie pune jozyrtare me deputetët, për të promovuar politikat dhe reformat gjinore, si edhe për të bashkëpunuar për integrimin e analizës me bazë gjinore në projekte të ndryshme të agjendës legjislative; dhe

- Së dyti, QKLKL mund të integrojë në mënyrë pro-aktive analizën LNGj në punën e vet. Për ta bërë këtë, QKLKL do të përfitonte nga forcimi i aftësive për të përdorur më mirë mjetet dhe burimet ekzistuese për të kryer analiza gjinore kuptimplota, si edhe për të arritur integrim më të mirë të të dhënave të ndara sipas seksit, të mbledhura nga KKS, në projekt-akte.

Shtojca II. Instrumenti i Vetëvlerësimit për Legjislacionin me Ndjeshmëri Gjinore

(a) Informacion i përgjithshëm

Titulli i legjislacionin (referuar më poshtë si "LIGJ") _____

Fusha e politikave: _____

Përshkrimi i LIGJIT: _____

Grupet/personat që pritet të preken nga LIGJI: _____

Përshkrim i shkurtër i situatës aktuale të LIGJIT (rrethi poshtë): _____

Hartimi / zbatimi / monitorimi / vlerësimi dhe shqyrtimi: _____

Zyrtari përgjegjës: _____ (Emri)

_____ (Pozicioni)

_____ (Zyra ose Departamenti)

_____ (Telefon) (E-mail)

(b) Hartimi

Përpilimi dhe analiza e informacionit gjinor

1. Para hartimit të LIGJIT, a janë mbledhur dhe a janë marrë parasysh të dhëna të ndara sipas seksit të personave që preken prej ligjit?
2. A tregojnë të dhënat dallime gjinore ose ndërveprime gjinore me këto karakteristika socio-ekonomike: moshë, arsimimi, statusi familjar, grupi i të ardhurave, paaftësia fizike apo të tjera (lutemi, specifikoni: _____)
3. Jepni një përmbledhje të të dhënave më lart: _____

Pjesëmarrja

4. A është konsultuar ndonjë prej grupeve më poshtë për ndikimin gjinor të LIGJIT:
 - (a) Specialistët gjinorë (p.sh., organizatat e grave, akademikët, qendrat kërkimore, think tank-et)
 - (b) Organet statutorë përkatëse
 - (c) Organizatat joqeveritare
 - (d) Përfituesit (si gratë edhe burrat) e mundshëm që pritet të preken në mënyrë pozitive ose negative nga LIGJI
5. Jepni emrat e aktorëve të konsultuar dhe një përmbledhje të opinionëve të tyre.

Vlerësimi i nevojave specifike të grave dhe burrave

6. A janë identifikuar nevojat specifike të grave dhe burrave dhe çështjet e tjera gjinore, si edhe a janë shqyrtuar dhe integruar në hartimin e LIGJIT?
7. A kërkon LIGJI ndonjë referencë specifike për gratë dhe burrat?

Vlerësimi i ndikimit të gratë

8. A do të ndikohen ndryshe prej LIGJIT gratë apo ndonjë nëngrup grash krahasuar me burrat? Në mënyrë pozitive apo negative?

9. A promovon LIGJI, në ndonjë mënyrë (drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në planin afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë), eliminimin e diskriminimit të grave përmes:

- (a) përmirësimit të legjislacionit, politikave apo programeve publike ekzistuese që kanë qenë diskriminuese ose disavantazhuese për gratë;
- (b) krijimit të mbrojtjes ligjore (dhe të tjera) të drejtave të grave;
- (c) forcimit të roleve vendimmarrëse të gratë;
- (d) rritjes së aksesit dhe kontrollit të burimeve nga ana e grave;
- (e) kontributit në fuqizimin e grave; si edhe
- (f) ndonjë mënyrë tjetër, p.sh., _____ ?

10. A do të vendosë LIGJI ndonjë kufizim apo pengesë ndaj grave (ose nëngrupeve të grave), qoftë edhe përkohësisht?

11. A është përdorur gjuhë gjinore neutrale/me ndjeshmëri gjinore në të gjithë legjislacionin / politikën publike / programin / informacionin publik apo në ndonjë dokument tjetër zyrtar?

(c) Zbatimi

Edukimi dhe promovimi publik

12. A është paraqitur informacioni promovues për LIGJIN duke shfaqur ndjeshmëri gjinore?

13. A ka arritur mediumi i promovimit (p.sh. vendet, kanalet apo intervalet kohore) në mënyrë efektive të gratë?

Ndikimi të gratë

14. A janë prekur ndryshe gratë apo ndonjë nëngrup grash nga procesi i zbatimit të LIGJIT krahasuar me meshkujt, p.sh. kriteret e pranimit, niveli i përfitimeve, aksesueshmëria apo disponueshmëria e mbështetjes? Në mënyrë pozitive apo negative?

15. A janë marrë masa për të trajtuar nevojat e grave gjatë zbatimit të LIGJIT?

(d) Monitorimi

Përpilimi dhe analiza e informacionit gjinor

16. A janë përgatitur të dhëna të ndara sipas seksit dhe tregues me ndjeshmëri gjinore (sasiorë dhe cilësorë) për të monitoruar procesin dhe rezultatet e LIGJIT?

Përfshirja e çështjeve gjinore

17. A merr parasysh mekanizmi monitorues perspektivat gjinore dhe shqetësimet e grave dhe të burrave?

(e) Vlerësimi dhe shqyrtimi

Analiza gjinore e ndikimit të gratë dhe burrat

18. A është kryer analizë gjinore për të vlerësuar dhe për të shqyrtuar hartimin, zbatimin dhe rezultatet e LIGJIT?

19. A ka identifikuar vlerësimi çështjet gjinore në mënyrë sistematike dhe a i ka adresuar ato?

20. A janë konsultuar ndonjë prej grupeve të mëposhtme gjatë vlerësimit të jashtëm (nëse është e zbatueshme) të LIGJIT:

- (a) Specialistët gjinorë (p.sh., organizatat e grave, akademikët, qendrat kërkimore, think tank-et)
- (b) Organet statutorë përkatëse
- (c) Organizatat joqeveritare
- (d) Përfituesit (si gratë edhe burrat) e mundshëm që pritet të preken nga LIGJI

21. A ka rezultuar LIGJI në ndonjë mënyrë (drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në planin afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë) në:

- (a) përmirësim të legjislacionit, politikës publike dhe/ose programit ekzistues që ka qenë diskriminues ose disavantazhues ndaj grave;
- (b) sigurimin e mbrojtjes ligjore (apo tjetër) për të drejtat e grave;
- (c) forcimin e rolit vendimmarrës të grave;
- (d) rritjen e aksesit dhe kontrollit të burimeve nga ana e grave;
- (e) kontribut për fuqizimin e grave; ose
- (f) ndonjë dinamikë tjetër _____ ?

22. A është vendosur ndonjë kufizim apo pengesë ndaj grave, burrave apo nëngrupi grash ose burrash?
23. A ka arritur personeli përgjegjës për shqyrtimin e raporteve që të garantojë reflektim dhe përfshirje në raport të mangësive dhe sukseseve gjinore të LIGJIT?

Planet për të ardhmen

24. A janë përdorur gjetjet e vlerësimit për të rritur ndjeshmërinë gjinore në proceset e ardhshme të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të LIGJIT dhe të legjislacionit, politikave publike dhe/ose programeve përkatëse?

(f) Administrata

Ndjeshmëria dhe forcimi i kapaciteteve të personelit

25. A ekziston një pikë fokale gjinore (person apo skuadër e caktuar) për LIGJIN?
26. A është informuar ose a është trajnuar personeli i ngarkuar me fazat më poshtë në lidhje me çështjet gjinore? Nëse po, specifikoni ose jepni hollësi.
- Hartimi _____
- Zbatimi _____
- Monitorimi _____
- Vlerësimi _____

Shtojca III. Shembuj të treguesve me ndjeshmëri gjinore në sektorin e arsimit

Objektivi	Treguesi(t)
Treguesit e kapitalit njerëzor	
Ngushtimi i hendekut gjinor në regjistrim, përfundim dhe rezultate mësimore në shkollimin fillor dhe të mesëm	<ul style="list-style-type: none">• Numri shtesë i vajzave dhe djemve që regjistrohen, ndjekin dhe përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm krahasuar me vitin(vitet) e kaluar(a)• Numri dhe përqindja e nxënësve femra dhe meshkuj që marrin mbështetje të drejtpërdrejtë (p.sh., rimbursime, bursa, transfertat të kushtëzuara në para ose shtesat ushqimore)• Normat e përsëritjes dhe të braktisjes së shkollimit fillor dhe të mesëm sipas gjinisë, etnisë dhe vendndodhjes (p.sh., rurale ose urbane)• Numri dhe lloji i aktiviteteve të synuara për të monitoruar dhe ndihmuar vajzat dhe djemtë në rrezik të braktisjes së shkollës, sipas nivelit të arsimit• Numri i vajzave dhe djemve që ndjekin institucionet arsimore që janë më të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara• Numri i vajzave dhe djemve që përfitojnë nga arsimi i veçantë.
Krijimi i infrastrukturës arsimore që përmbush nevojat e nxënësve djem dhe vajza si edhe të mësuesve gra dhe burra	<ul style="list-style-type: none">• Numri i shkollave në zona që zvogëlojnë distancën shtëpi-shkollë për vajzat dhe djemtë• Numri i fjetinave/konvikteve të ndërtuara ose të rinovuara, si edhe numri dhe përqindja e vajzave dhe djemve përfitues• Përqindja e institucioneve arsimore që ofrojnë ambiente private të sigurta strehimi dhe sanitare, sipas nivelit të arsimit• Përqindja e strehimit që iu ofrohet mësuesve gra dhe burra në zonat e largëta dhe rurale, sipas nivelit të arsimit• Numri i objekteve të reja ose të rinovuara neutrale ndaj gjinisë, që synojnë të përmirësojnë mjedisin mësimor për vajzat dhe djemtë (p.sh. biblioteka, laboratorë dhe ambiente sportive)

Treguesit e fuqizimit ekonomik

Ngushtimi i pabarazive gjinore në punësimin e grave në sektorin e arsimit

- Numri dhe përqindja e mësuesve gra dhe burra të kualifikuar
- Numri dhe përqindja e mësuesve gra dhe burra të trajnuar, sipas fushës (p.sh. metoda planifikimi, menaxhimi dhe mësimdhënëse)
- Përqindja e mësuesve gra dhe burra në arsimin fillor, të mesëm dhe tretësor (publik dhe privat)
- Përqindja e grave dhe burrave në poste mësimdhënëse të larta, menaxhim dhe poste shqyrtimi programesh mësimore (p.sh. supervisor, drejtor, zv.drejtor dhe shef departamenti)
- Përqindja e mësueseve gra dhe burra në zonat e largëta dhe rurale, si edhe përqindja e mësuesve të kualifikuar (sipas standardeve minimale)
- Numri dhe lloji i programeve me incentiva dhe mbështetje për rekrutimin, trajnimin dhe avancimin në karrierë, përfshirë ato që synojnë rritjen e numrit të personelit mësimdhënës të kualifikuar (gra dhe burra) në zonat rurale
- Përqindja e grave dhe burrave që marrin trajnim në punë ose në distancë, krahasuar me përqindjen totale të grave dhe burrave që kanë nevojë për trajnim (mësues dhe zyrtarë shkollash)

Ngushtimi i pabarazive gjinore në punësimin e grave në këto sektorë të ekonomisë: jotradicionale, me të ardhura të larta dhe sektori i rritjes

- Ndryshimi i përqindjes në regjistrimin e grave dhe përqindjet e përfundimit të studimeve në arsimin teknik dhe profesional, përfshirë fushat e dominuara tradicionalisht prej burrave dhe sektorët e rritjes të ekonomisë
- Numri dhe përqindja e nxënësve djem dhe vajza që marrin rimbursime, bursa ose mbështetje tjetër financiare për arsimin teknik dhe profesional.

Ngushtimi i hendekut gjinor në arsimin teknik dhe profesional, si edhe tretësor

- Numri dhe lloji i aktiviteteve nxitëse (me incentiva) dhe mbështetëse që iu mundësojnë grave dhe burrave regjistrimin në institucionet trajnuese (p.sh. politika veprimi afirmative, shqyrtim i kualifikimeve ose procedurave të përzgjedhjes)
- Numri dhe përqindja e të diplomuarve gra dhe burra (të larguar nga shkolla, të diplomuarit nga universiteti, shkollat teknike dhe profesionale) që sigurojnë punësim në profilin e studimeve
- Numri dhe përqindja e grave dhe burrave që përfitojnë nga programet e sistemit në industri

Forcimi i kalimit nga shkollimi në një vend pune dinjitoz për të rinjtë (të larguarit nga shkolla, studentët e diplomuar nga universiteti, si edhe nga shkollat teknike dhe profesionale)

- Evidencat e këshillimit dhe aktiviteteve mbështetëse që synojnë të ndihmojnë kalimin e grave në punësimin në këto sektorë të ekonomisë: jotradicional, me të ardhura të larta dhe sektorë të rritjes
- Përqindja e grave dhe burrave që diplomohen në juridik, shkenca, mjekësi dhe teknologji informacioni dhe komunikimi
- Numri i objekteve të kujdesit shëndetësor për studentët gra dhe burra që kanë detyrime prindërore
- Numri dhe lloji i programeve arsimore joformale që iu ofrohen grave dhe burrave, sipas fushës
- Numri dhe përqindja e grave dhe burrave që përfundojnë këto programe
- Numri dhe përqindja e këshilltarëve/orientuesve gra dhe burra për avancimin në karrierë, të cilët janë trajnuar për çështjet gjinore
- Përqindja vjetore e bursave kombëtare dhe ndërkombëtare afatshkurtra që iu jepen grave dhe burrave për trajnim, sipas fushës (për arsimin e lartë dhe studimet pasuniversitare)

Zëri dhe të drejtat

Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen për politikën e arsimit, reformat dhe praktikën e institucioneve arsimore

- Numri dhe përqindja e grave të përfshira në formulimin dhe shqyrtimin e politikave dhe strategjive arsimore, programeve mësimore, si edhe të materialeve mësimdhënëse dhe mësimore
- Përqindja e grave në këshillat e shkollave
- Përqindja e grave dhe burrave që mbajnë poste në këshillat e shkollave dhe bordet arsimore
- Përqindja e grave dhe burrave në shoqatat profesionale të mësuesve, krahasuar me numrin total të mësuesve gra dhe burra, si edhe përqindja e grave dhe burrave që mbajnë poste zyrtare.

Burimi: Përshtatur sipas Mjetet për Rezultatet dhe Treguesit e Barazisë Gjinore (2013) që ofron shembuj shtesë për treguesit me ndjeshmëri gjinore në sektorët e financave, shëndetësisë, transportit, zhvillimit urban, etj.¹

¹ Mjetet për Rezultatet dhe Treguesit e Barazisë Gjinore, (Qyteti Mandaluyong: Banka Aziatike për Zhvillim, 2013), <<https://www.adb.org/documents/tool-kit-gender-equality-results-and-indicators>>.

Fjalor

Gjinia është një term që përdoret për të përshkruar rolet e ndërtuara në shoqërori për gratë dhe burrat. Gjinia është një identitet i fituar që mësohet, ndryshon me kalimin e kohës dhe ndryshon shumë brenda dhe midis kulturave. Nga ana tjetër, seksi identifikon dallimet biologjike mes burrave dhe grave. Rolet me bazë seksi janë universale dhe nuk ndryshojnë me kalimin e kohës ose midis kulturave.³⁴

Analiza Gjinore përfshin mbledhjen dhe analizën e të dhënave të ndara sipas seksit për të zbuluar ndonjë ndikim të diferencuar të një veprimi/politike ndaj grave dhe burrave, si edhe efektet e roleve dhe përgjegjësive gjinore. Analiza gjinore përfshin edhe analiza cilësore që ndihmojnë për të sqaruar se si dhe pse kanë ndodhur këto role, përgjegjësi dhe ndikime të diferencuara.³⁵

Analiza Gjinore e Buxhetit analizon se si programet e financuara trajtojnë nevojat e gjinive të ndryshme dhe të grupeve shoqërore të ndryshme. Një rezultat i analizës gjinore të buxhetit janë rekomandimet për përmirësime në programet buxhetore, politikat fiskale dhe sektoriale, me qëllim që programet dhe politikat t'iu përgjigjen më mirë nevojave të sekseve të ndryshme dhe të grupeve shoqërore të ndryshme.³⁶

Diskriminimi Gjinor i referohet çdo diferencimi, përjashtimi apo kufizimi që bëhet mbi bazën e normave dhe roleve gjinore të ndërtuara në shoqëri, që e pengojnë individin të gëzojë plotësisht të drejtat e njeriut.³⁷

34 Fjalorth me terma gjinorë (Vjenë, OSBE, maj 2006), <<http://www.osce.org/gender/26397?download=true>>.

35 Po aty.

36 Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor: Analizë e Programeve Buxhetore nga Perspektiva Gjinore (Kiev, UN Women, 2016) <<http://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/05/gender-responsive-budgeting--analysis-of-budget-programmes-from-gender-perspective#view>>.

37 Fjalorth me terma gjinorë, op. cit., shënimi 36.

Hendeku Gjinor është hendeku në çfarëdo fushe mes grave dhe burrave, për sa i përket shkallës së pjesëmarrjes, aksesit, të të drejtave, shpërblimit dhe përfitimeve.³⁸

Barazia Gjinore nënkupton të drejta dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në ligje dhe politika, si edhe akses të barabartë në burime dhe shërbime në familje, komunitete dhe shoqëri. Barazia gjinore nënkupton që burrat dhe gratë kanë akses dhe pjesëmarrje në shkallë të barabartë në të gjitha fushat e jetës, përfshirë qeverisjen demokratike, vendimmarrjen dhe sektorin e sigurisë. Ajo kërkon që burrat dhe gratë të marrin mbrojtje adekuata dhe të barabartë të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për të jetuar pa dhunë në shtëpi dhe komunitet të sigurt dhe mbështetës.³⁹

Vlerësimi i Ndikimit Gjinor nënkupton shqyrtimin e politikave të propozuara, për të parë nëse ndikojnë në mënyrë të ndryshme te gratë dhe burrat, me qëllim që këto politika të përshtaten në mënyrë të tillë që të eliminojnë efektet diskriminuese dhe të promovojnë barazinë gjinore.⁴⁰

Integrimi i perspektivës së barazisë gjinore është procesi i vlerësimit të implikimeve që ka çdo veprim i planifikuar te gratë dhe burrat, përfshirë legjislacionin, politikat apo programet, në çfarëdo fushe dhe në të gjitha nivelet. Kjo është një strategji për t'i bërë shqetësimet dhe përvojat e grave dhe burrave dimension të pandashëm në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe politikave në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe sociale, me qëllim që pabarazia mes burrave dhe grave të mos thellohet.⁴¹

Neutralitet Gjinor do të thotë që nuk ka ndikim të diferencuar pozitiv apo negativ në marrëdhëniet gjinore apo në barazinë mes grave dhe burrave.⁴²

Pariteti Gjinor është koncept numerik që shpreh barazinë relative në shifra dhe proporcione ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve. Në arsim, kjo do të thotë se i njëjti numër djemsh dhe vajzash marrin shërbime arsimore në nivele të ndryshme dhe në forma të ndryshme.⁴³

38 Mjetet e BE-së për Integrimin Gjinor në bashkëpunimin për zhvillim: Fjalorth i termave për gjininë dhe zhvillimin (Bruksel: Komisioni Evropian, 2004), < <http://library.e.uneighbours.eu/content/eu-toolkit-mainstreaming-gender-development-cooperation-glossary-gender-and-development-term>>.

39 Barazia Gjinore dhe Të Drejtat e Grave (Varshavë: Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe Të Drejtat e Njeriut, 2017), <<http://www.osce.org/odihr/303541?download=true>>.

40 Mjetet e BE-së, op. cit., shënimi 40.

41 Fjalorth me terma gjinorë, op. cit., shënimi 36.

42 Mjetet e BE-së, op. cit., shënimi 40.

43 Analizë Gjinore në Arsim: Këndvështrim Konceptual (Nju Jork: UNGEL, 2012) <http://www.ungei.org/files/Gender_Analysis_in_Education.pdf>.

Marrëdhëniet Gjimore janë marrëdhëniet dhe shpërndarja e pabarabartë e pushtetit ndërmjet grave dhe burrave që karakterizojnë çdo sistem gjinor specifik.⁴⁴

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator është një qasje që synon të integrojë perspektivat gjimore në tërë procesin e planifikimit dhe buxhetimit në të gjitha nivelet e qeverisjes. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinator synon të ristrukturojë të ardhurat dhe shpenzimet në mënyrë të tillë që nevojat, interesat dhe prioritetet si të grave, ashtu edhe të burrave, të merren parasysh në mënyrë të barabartë gjatë procesit të hartimit të buxheteve dhe politikave qeveritare.⁴⁵

Ndeshmëria/Ndërgjegjësimi Gjinator përmbledh aftësinë për të perceptuar, njohur dhe nënvizuar diferencat gjimore ekzistuese, problematikat dhe pabarazitë, si edhe për të përfshirë perspektivën gjimore në strategji dhe veprime.⁴⁶

Treguesit me Ndeshmëri Gjimore japin informacion për progresin në përpjekjet drejt barazisë gjimore. Një tregues përmbledh një sasi të madhe informacioni në një shifër të vetme, me qëllim që të tregojë një aspekt të avantazhit apo disavantazhit ndërmjet burrave dhe grave dhe të tregojë ndryshimin me kalimin e kohës. Treguesit dallojnë nga të dhënat statistikore, sepse shkojnë përtej thjesht paraqitjes së fakteve: treguesit bëjnë edhe krahasim.⁴⁷

Hendeku Profesional/Gjinator nënkupton përqendrimin e grave dhe burrave në lloje dhe nivele të ndryshme të aktivitetit ekonomik dhe punësimit, ku gratë janë të kufizuara në një rang më të ngushtë profesionale (ndarja horizontale) sesa burrat, si edhe në shkallë hierarkike më të ulëta (ndarja vertikale).⁴⁸

Seksi i referohet dallimeve biologjike ndërmjet grave dhe burrave.⁴⁹

Të Dhëna të Ndara sipas Seksit nënkuptojnë mbledhjen dhe paraqitjen e të gjitha statistikave veçmas për gratë dhe burrat.⁵⁰

44 Mjetet e BE-së, op. cit., shënimi 40.

45 Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator, op. cit., shënimi 38.

46 Fjalorth me terma gjinorë, op. cit., shënimi 36.

47 Po aty.

48 Mjetet e BE-së, op. cit., shënimi 40.

49 Analizë Gjimore në Arsim, shënimi 45.

50 Fjalorth me terma gjinorë, op. cit., shënimi 36.

Bibliografi

Për integrimin gjinor

A Comparative Analysis of Gender Equality Law in Europe (Brussels: European Commission, 2016), <http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/your_rights/comparative_analysis_of_gender_equality_law_in_europe-2015.pdf>.

A Comparative Study of Structures for Women MPs in the OSCE Region (Warsaw: OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights, 2013), <<http://www.osce.org/odihr/105940?doenload=true>>.

Drafting Gender-Aware Legislation: How to Promote and Protect Gender Equality in Central and Eastern Europe and in the Commonwealth of Independent States (Bratislava: UNDP, 2003), <<http://iknowpolitics.org/sites/default/files/drafting20gender-aware20legislation.pdf>>.

Equality in Politics: A Survey of Women and Men in Parliaments (Geneva: Inter-Parliamentary Union, 2008) <<http://www.ipu.org/pdf/publications/equality08-e.pdf>>.

“Europe: A Survey of Gender Budgeting Efforts”, Working Paper, WP/16/155, IMF, July 2016, <<https://www.imf.org/external/pubs/cat/longres.aspx?sk=44148.0>>.

EU Toolkit on Mainstreaming Gender in Development Cooperation: Glossary of gender and development terms (Brussels: European Commission, 2004), <<http://library.euneighbours.eu/content/eu-toolkit-mainstreaming-gender-development-cooperation-glossary-gender-and-development-term>>.

Gender Analysis in Education: A Conceptual Overview (New York: UNGEI, 2012), <http://www.ungei.org/files/Gender_Analysis_in_Education.pdf>.

“Gender Budgeting in OECD countries”, OECD, June 2016, <<http://www.oecd.org/gov/budgeting/latestdocuments/>>.

Gender Equality and Women’s Rights (Warsaw: OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights, 2017), <<http://www.osce.org/odihr/303541?download=true>>.

Gender Glasses in use: A handbook to support gender equality work at Finnish ministries (Helsinki: Finnish Ministry of Social Affairs and Health, 2013), <<http://julkaisut.valtioneuvosto.fi/handle/10024/74721>>.

Gender Mainstreaming: An Overview (New York: United Nations, 2002), <<http://www.un.org/womenwatch/osagi/pdf/e65237.pdf>>.

Gender Mainstreaming in the Work of UNODC (Vienna: UNODC, 2013), <<http://www.un.org/womenwatch/directory/docs/UNODC-GuidanceNote-GenderMainstreaming.pdf>>.

Gender-Responsive Budgeting: Analysis of Budget Programmes from Gender Perspective (Kyiv, UN Women, 2016), <<http://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/05/gender-responsive-budgeting--analysis-of-budget-programmes-from-gender-perspective#vieëw>>.

Glossary on Gender-Related Terms (Vienna: OSCE, May 2006), <<http://www.osce.org/gender/26397?doëload=true>>.

Guidance Note: Strategies and Good Practices in Promoting Gender Equality Outcomes in Parliaments (UNDP, 2016), <http://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/democratic-governance/parliamentary_development/guidance-note---strategies-and-good-practices-in-promoting-gende.html>.

Indicators for Measuring Results on Gender Equality (Stockholm: Swedish International Development Agency/ SIDA, 2010), <<http://www.focusintl.com/GD195-%20Indicators%20for%20Measuring%20Results%20on%20Gender%20Equality.pdf>>.

Introduction to Gender Analysis and Gender Sensitive Indicators (Turin: UNIFEM, 2009), <<http://www.focusintl.com/GD124d-%20Gender%20Campus%20Module%20bis%20-%20Introduction%20to%20Gender%20sensitive%20indicators.pdf>>.

Munn-Rivard, Laura, "Gender Sensitive Parliaments: The Work of Legislators," Parliamentary Information and Research Service: Library of Parliament, Ottawa, 2013, <<https://www.agora-parl.org/resources/library/gender-sensitive-parliaments-2-work-legislators>>.

Palmieri, Sonia, *Gender Sensitive Parliaments: A Global Review of Good Practice* (Geneva: Inter-Parliamentary Union, 2011), <<http://www.ipu.org/pdf/publications/gsp11-e.pdf>>.

Parliaments and Gender Equality: Gender Mainstreaming in Legislatures (Panama: UNDP, June 2013), <http://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/democratic-governance/parliamentary_development/parliaments-and-gender-equality.html>.

Plan of Action for Gender-sensitive Parliaments (Geneva: Inter-Parliamentary Union, October 2012), <<http://www.ipu.org/pdf/publications/action-gender-e.pdf>>.

"Progress of the World's Women 2015-2016", UN Women, 2015, <<http://progress.unwomen.org/en/2015/>>.

Tool Kit on Gender Equality Results and Indicators (Mandaluyong City: Asian Development Bank, 2013), <<https://www.adb.org/documents/tool-kit-gender-equality-results-and-indicators>>.

“Women’s Budget Initiative: South Africa”, World Bank, 2010, <http://siteresources.worldbank.org/INTEMPowerment/Resources/14659_S-Afr-Wmn-Budg-web.pdf>.

“World Development Report on Gender Equality and Development”, World Bank, 2012, <<https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/4391>>.

Për Bjellorusinë

Ananyeu, Dzmitry, et al., “Country Report Participation of Women in Public and Political Life, Belarus”, 2013, <<https://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:udzuoNYCcXsJ:https://rm.coe.int/1680599095+&cd=1&hl=en&ct=clnk&gl=pl>>.

Burova, S. & Yanchuk, O., “Analysis of the Gender Sector in Belarus”, Office for European Expertise and Communications, 2014, <<http://eng.oeec.by/wp-content/uploads/2015/06/Analysis-of-Gender-Sector-in-Belarus.pdf>>.

“Concluding observations on the eighth periodic report of Belarus”, UN Committee on the Elimination of Discrimination against Women, November 2016, <http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Doenload.aspx?symbolno=CEDAW%2fC%2fBLR%2fCO%2f8&Lang=en>.

“Consideration of reports submitted by States parties under article 18 of the Convention of the Convention pursuant to the simplified reporting procedure: Eighth periodic report of States parties due in 2016”, UN Committee on the

Elimination of Discrimination against Women, June 2016, <http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2fC%2fBLR%2f8&Lang=en>.

“Improving Gender Statistics for Decision-Making,” Conference of European Statisticians, Work Session on Gender Statistics, Economic Commission for Europe, 17 May 2016, <https://www.unece.org/stats/documents/2016.6.gender.html#>.

Petina, Ludmila, et al., “Shadow Report: The Republic of Belarus – 2010, On the Implementation of the Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women”, 2010, <http://www2.ohchr.org/english/bodies/CEDAW/docs/ngo/PAWIDM_Belarus48.pdf>.

“Shadow Report: The Republic of Belarus – 2016 on the Implementation of the Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women”, The International Centre for Gender Initiatives“, <http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/BLR/INT_CEDAW_NGO_BLR_25445_E.pdf>.

osce Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

